

RAPORTI VJETOR

AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS



AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS



RAPORTI VJETOR 2019

RAPORTIMI I AKTIVITETEVE TE
ZHVILLUARA DHE PASQYRES FINANCIARE

DHJETOR 2019





PERMBAJTJA

HYRJE

I. AGJENCIA KOMBETARE E DIASPORES

1.1 MISIONI

1.2 DETYRAT

II. ORGANET DREJTUESE

2.1 KESHILLI DREJTUES

2.2 DREJTORI EKZEKUTIV

2.3 STRUKTURA ADMINISTRATIVE

III. AGJENCIA KOMBETARE E DIASPORES PER VITIN 2019

3.1 ZBATIMI I STRATEGJISE KOMBETARE DHE PLANIT TE VEPRIMIT 2018-2024

3.2 BULETINI I MASAVE TE PLANIT TE VEPRIMIT

3.3 GRUPI I KOORDINATOREVE

IV. KOMITETI SHTETEROR PER DIASPOREN

V. GRUPET NDERINSTITUCIONALE TE PUNES

VI. KESHILLI KOORDINUES I DIASPORES

VII. AMBASADORET E KOMBIT

VIII. SAMITI I DYTE I DIASPORES

8.1 PJESEMARRJA NE SAMITIN E DYTE TE DIASPORES

8.2 PANELET E DISKUTIMIT GJATE SAMITIT

8.3 AKTIVITETE GJATE SAMITIT TE DYTE TE DIASPORES





8.4 TRANSPARENCA E SHPENZIMEVE TE SAMITIT

IX. RAPORTIM I DREJTORISE SE DIASPORES

9.1 AKTIVITETET E AGJENCISE KOMBETARE TE DIASPORES

9.2 AKTIVITETE PER KOMUNITETIN SHQIPTAR NE UKRAINE

9.3 AKTIVITETE PER KOMUNITETIN SHQIPTAR NE ITALI

9.4 AKTIVITETE PER KOMUNITETIN SHQIPTAR NE KROACI

9.5 TE NJOHIM KOMUNITETET TONA NE DIASPORE

9.6 DITET E SHQIPERISE

9.7 ORGANIZIME TE TJERA

9.8 PLANI I PUNES PER 2020

***X. RAPORTIM I DREJTORISE SE FINANCES DHE SHERBIMEVE
MBESHTETESE***

10.1 ANALIZA FINANCIARE E VITIT 2019

*10.2 ORGANIZIMI I DREJTORISË SË FINANCËS DHE
SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE*

XI. MARREVESHJE BASHKEPUNIMI

XII. PUBLIKIME TE AGJENCISE KOMBETARE TE DIASPORES

SHTOJCA 1: AKTE TE KESHILLIT DREJTUES SIPAS MBLEDHJEVE

SHTOJCA 2: TREGUES I LEGJISLACIONIT NE VITIN 2019



HYRJE

Agjencia Kombëtare e Diasporës është një ndër institucionet kryesore shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me Diasporën shqiptare. Agjencia ka për mision nxitjen dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me Diasporën, me qëllim zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse për angazhimin e Diasporës në zhvillimin ekonomi, politik, social dhe kulturor të Shqipërisë.

Një ndër detyrat kryesore të Agjencisë, të parashikuara në Ligjin nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, është përgatitja e një raporti periodik mbi veprimtarinë vjetore të Agjencisë. Në zbatim të këtij ligji është përgatitur edhe Raporti Vjetor 2019, paraqitur më poshtë.

Raporti është një përmbledhje e funksioneve dhe aktiviteteve institucionale të realizuara nga Agjencia dhe shërben për të informuar institucionet përkatëse rreth veprimtarisë dhe arritjeve të Agjencisë gjatë 2019-ës si dhe prezantimi i parashikimit të zbatimit të aktiviteteve gjatë 2020-ës. Disa prej çështjeve kryesore të trajtuara në raport janë: statusi ligjor i Agjencisë Kombëtare të Diasporës; struktura e institucionit, veprimtaria e institucionit gjatë vitit 2019 dhe realizimi i buxhetit për vitin 2019; aktivitetet institucionale; si dhe pasqyra financiare për 2019-ën dhe 2020-ën si dhe aktet ligjore.

Ndër arritjet e vitit 2019 të Agjencisë vlen për tu përmendur funksionimi dhe krijimi i përvojës administrative në një fushë veprimi sic janë marrëdhënia me komunitet shqiptare në diasporë. Po ashtu një arritje e rëndësishme është fillimi i punës të strukturave ligjore si Këshilli Koordinues i Diasporës, si edhe zhvillimi me sukses i Samitit të Dytë të Diasporës në Shqipëri. Hartimi i programeve të veçanta për komunitetet shqiptare më të vjetra si ato të Ukrainës, Kroacisë, Bullgarisë e Italisë janë vetëm fillimi i një pune me mjaft sfida pranë komuniteteve shqiptare në diasporë.





I. AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

Agjencia Kombëtare e Diasporës (Agjencia) është person juridik publik, me statusin e "agjencisë autonome", me seli në Tiranë. Agjencia funksionon në bazë të Ligjit Nr. 115/2017 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës". Agjencia ushtron veprimtarinë e saj që prej vitit 2018 nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Shtetit për Diasporën.

1.1 MISIONI

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka për mision zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, nëpërmjet:

- a) përmirësimit të pozitës së diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të saj, aty ku gjendet;
- b) ofrimit të ndihmës për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare;
- c) nxitjes së bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës;
- d) bashkëpunimit për prosperitetin, paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror të gjithë kombit.

1.2 DETYRAT

Detyrat e Agjencisë Kombëtare të Diasporës janë:

- Merr masa për krijimin e bazës unike të të dhënave të diasporës, në bazë të vullnetit të lirë të personit. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Zbaton politika dhe projekte që lidhen me diasporën.
- Përgatit raporte periodike për veprimtarinë e Agjencisë, të cilat ia paraqet për miratim ministrit përgjegjës për diasporën.
- Përgatit dhe koordinon punën për hartimin dhe rishikimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe ndjek zbatimin e saj.
- Mban lidhjet ndërmjet diasporës, përfaqësuesve të saj dhe vendit të origjinës.
- Përgjigjet për funksionimin dhe menaxhimin financiar të Agjencisë.
- Bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit, për përmirësimin e pozitës së diasporës.
- Ndhmon në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, vlerave kombëtare dhe kulturore të diasporës.
- Informon diasporën mbi proceset politike në vendin e origjinës, me qëllim përfshirjen e tyre në jetën politike, ekonomike dhe kulturore të Republikës së Shqipërisë.



II. ORGANET DREJTUESE

Në përputhje me pikën 3 të nenit 5 të Ligjit Nr. 115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare për Diasporën”, organet drejtuese të Agjencisë janë:

- Këshilli Drejtues
- Drejtori Ekzekutiv

2.1 KESHILLI DREJTUES

Këshilli Drejtues është organi vendimmarrës për çështjet administrative dhe financiare të Agjencisë. Mënyra e organizimit dhe funksionimit, si dhe kompetencat e Këshillit Drejtues rregullohen përmes Ligjit Nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” si dhe Vendimit Nr. 114/2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për emërimin, shkarkimin dhe shpërbllimin e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Diasporës përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët zgjidhen nga titullarët e Institucioneve të Administratës Publike të parashikuara në nenin 7 të Ligjit Nr.115/2017.

Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Diasporës ka këto kompetenca:

- Miraton programet e zhvillimit të Agjencisë, në përputhje me dokumentet strategjike për marrëdhëniet me diasporën;
- Miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ, funksionet dhe përgjegjësitë e strukturave të brendshme e të stafit administrativ e mbështetës;
- Ushtron kompetencat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Propozon strukturën, organikën dhe nivelin e pagave të punonjësve të Agjencisë;
- Miraton buxhetin, planin e veprimit, planin financiar, raportin vjetor dhe raporte të tjera të Agjencisë;
- Merr vendime për çështje të tjera, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

Gjatë vitit 2019 Këshilli Drejtues, me propozimin e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kombëtare të Diasporës ka marrë vendimet e mëposhtme:

1. Vendimi Nr. 1, datë 04.02.2019 “Për miratimin e Planit për Detajimin Buxhetor për vitin 2019”
2. Vendimi Nr. 2, datë 18.03.2019 “Për miratimin e Raportit vjetor 2018, Aktivitetet e zhvilluara dhe Pasqyra Financiare”
3. Vendim Qarkullues Nr.3, datë 26.08.2019 “Për miratimin e Programeve të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për periudhën Gusht-Dhjetor 2019”





4. Vendim Qarkullues Nr. 4, datë 05.11.2019 “Për miratimin e programeve të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për Periudhën Nëntor-Dhjetor 2019”.

Vendimet e Këshillit janë bashkëlidhur në Shtojcën 1 të këtij Raportimi.

2.2 DREJTORI EKZEKUTIV

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Diasporës është autoriteti më i lartë ekzekutiv i saj. Ai është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e Agjencisë.


Drejtori Ekzekutiv përfaqëson Agjencinë Kombëtare të Diasporës në marrëdhënie me të tretët. Ai emërohet në detyrë nga ministri përgjegjës për diasporën, në përputhje me ligjin për statusin e nëpunësit civil. Gjatë vitit 2019, në periudhën janar – prill detyra e Drejtorit Ekzekutiv është mbajtur nga z. Dritan Delija (i komanduar); në periudhën prill – shtator kjo detyrë është ushtruar nga Drejtoresha e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (e komanduar) znj. Etleva Kondi dhe për periudhën në vazhdim funksionet e Drejtorit Ekzekutiv janë kryer nga Drejtori i Drejtorisë së Diasporës (i komanduar) z. Dritan Delija.

Drejtori Ekzekutiv raporton në Këshillin Drejtues për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

2.3 STRUKTURA ADMINISTRATIVE

Struktura administrative e Agjencisë Kombëtare të Diasporës është miratuar me Urdhrin Nr. 53, datë 16.03.2018 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës”. Sipas kësaj strukture të miratuar, Agjencia është e përbërë nga dy Drejtori dhe me një personel prej 15 punonjësish.

Bazuar në Urdhrin Nr. 53/2018 të Kryeministrit, struktura dhe organika e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, është sipas tabelës së mëposhtme:



Sipas organizimit strukturor të miratuar, Agjencia është e përbërë nga dy drejtori: Drejtoria e Diasporës dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Drejtoria e Diasporës është përgjegjëse:

- Për koordinimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit të saj;
- Për planifikimin, organizimin dhe zbatimin e detyrimeve të lidhura me qëllimet dhe aktivitetin e Agjencisë.

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjëse:

- Për administrimin e buxhetit të miratuar dhe veprimtarinë financiare të Agjencisë;
- Për përgatitjen e projekt-buxhetit dhe për administrimin e çdo çështjeje që lidhet me hartimin e planit financiar buxhetor afatmesëm e vjetor me qëllim arritjen e objektivave dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore të Agjencisë.





III. AGJENCIA KOMBETARE E DIASPORES NE VITIN 2019

3.1 ZBATIMI I STRATEGJISE KOMBETARE TE DIASPORES DHE PLANIT TE VEPRIMIT 2018 - 2024

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në zbatim të detyrave funksionale të saj, ndjek zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2018 – 2024, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 259 datë 09.05.2018 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të Planit të Veprimit”. Gjatë vitit 2019 Agjencia Kombëtare e Diasporës ka koordinuar veprimtarinë administrative ndërmjet institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë, si dhe ka bashkëpunuar me to për realizimin në afat të masave të Planit të Veprimit.

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në përputhje me ligjin Nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” ndjek dhe koordinon punën për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Gjatë Samitit të Dytë të Diasporës, sic ishte parashikuar, u diskutua për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Në bashkëpunim me zyrën në Tiranë të Organizatës Ndërkombëtare për Migracion (IOM) nga ekspertët e ftuar prej saj u vlerësua mënyra e rishikimit të Strategjinë Kombëtare të Diasporës. Mbi bazën e këtyre propozimeve u shkruajt dokumenti i Projekt Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021 – 2025. Ky projekt nuk përfaqëson konkluzione përfundimtare të institucioneve shtetërore, por është një dokument i hapur i cili i nënshtrohet fazave të mëposhtme:

- Faza e parë përkon me mbledhjen e opinioneve me shkrim nga individë dhe ekspertë të ndryshëm të diasporës (përfunduar brenda muajit nëntor 2019);
- Faza e dytë konsiston në diskutimin në publik të projekt-dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës (do të realizohet brenda muajit mars 2020);
- Faza e tretë përfshin bashkërendimin e strategjisë dhe miratimin e saj me Vendim të Këshillit të Ministrave (do të realizohet brenda muajit qershor 2020).

Parashikohet që të tre fazat e mësipërme të karakterizohen nga fleksibiliteti me qëllim realizimin e një dokumenti sa më të plotë. Projekt Strategjia 2021 – 2025 synon të përafrojë zhvillimet më të fundit në politikën për Diasporën shqiptare duke pasur parasysh qëllimet e saj për të ardhmen.

Për fazën e parë të Projekt Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021 – 2025 u realizua procesi i konsultimit publik në platformën elektronike www.konsultimipublik.gov.al dhe u mblodhën komentet dhe sugjerimet nëpërmjet emailit zyrtar info@akd.gov.al. Vazhdon puna në koordinim me institucionet shtetërore përgjegjëse.





3.2 BULETINI I MASAVE TË PLANIT TË VEPRIMIT

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka vijuar të publikojë çdo tre mujor buletin e për zbatimin e masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Buletini synon të informojë publikun e gjerë, anëtarët e Komisionit për Politikën e Jashtme pranë Kuvendit, anëtarët e Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin, anëtarët e Këshillit Shtetëror të Diasporës dhe Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës dhe publikun e gjerë në angazhimin e çdo institucioni përgjegjës në zbatimin e masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018-2024.

Gjatë vitit 2019 u publikuan Buletini Nr. 1 (mars 2019) Buletini Nr. 2 (qershor 2019), Buletini Nr. 3 (shtator 2019), Buletini Nr. 4 (dhjetor 2019) dhe Buletini vjetor 2019 (si përmbledhës i buletineve të publikuar gjatë një viti).

Publikimi i buletineve tre mujorë shërben si një praktikë bazuar në parimin e transparencës dhe nxit llogaridhënien institucionale. Ai bën publike punën e Agjencisë Kombëtare të Diasporës përpara një komuniteti jo prezent në vendlindje, siç është diaspora shqiptare.

3.3 GRUPI I KOORDINATOREVE

Në zbatim të Urdhrit Nr. 98/2018 të Kryeministrit “Për përcaktimin e Grupit të Koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024”, Agjencia Kombëtare e Diasporës organizoi mbledhjet e Grupit të Koordinatorëve për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës si më poshtë:

8 janar

Në këtë mbledhje u diskutua mbi publikimin e Buletinit Vjetor 2018 dhe angazhimin e institucioneve për zbatimin e masave që fillojnë zbatimin në 6 mujorin e parë të vitit 2019. Në mbledhje u trajtuan detajet teknike të organizimit të Samitit të Dytë të Diasporës bë datat 28 shkurt -2 mars 2019 si dhe u vlerësua Raporti i parë i INSTAT “Diaspora e Shqipërisë në shifra”.

19 shkurt

Në këtë mbledhje u diskutua mbi organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës, angazhimin e secilit prej tyre dhe pjesëmarrjen përmes standave informuese për diasporën.

07 mars

Diskutimi u përqendrua në angazhimin që pati secili nga institucionet në mbarëvajtjen e Samitit të Dytë të Diasporës si dhe në propozimet e paraqitura nga pjesëmarrësit në punimet e Samitit. Po ashtu u prezantua projekti i bashkëpunimit me institutin AlbShkenca për organizimin e një aktiviteti me rrjetin e profesionistëve të Universiteteve në Shqipëri, Mal të Zi dhe Kosovë.



29 mars

Çështja kryesore e diskutuar në mbledhje konsistente në zbatimin e masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës për 6 mujorin e parë të vitit 2019 dhe publikimin e Buletinit Nr. 1, mars 2019. U nxit koordinimi i institucioneve që të angazhohen dhe bashkëpunojnë në zbatimin e masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën.

15 prill

U krye vlerësim mbi zbatimin e masave të Planit të Veprimit nga ana e institucioneve përgjegjëse. Nxitja në proces e miratimit të përcaktimit të koordinatorit shtetëror për shtetasit që u është hequr liria jashtë vendit dhe koordinatori shtetëror për njehsimin e lejeve të drejtimit të automjeteve.

12 qershor

U diskutua mbi konkluzionet e publikimit të Buletinit Nr. 2, qershor 2019 dhe mbi afatet dhe rishikimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018-2024 sipas ekspertizës së IOM.

09 shtator

Diskutimi u fokusua mbi zbatimin e masave të Planit të Veprimit dhe publikimin e Buletinit Nr. 3, shtator 2019. U bë vlerësimi i organizimit të Takimit të XIV-të Ndërkombëtar “Kërkimi Shkencor në Hapësirën Mbarë Shqiptare dhe Roli i Diasporës Shkencore” nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Instituti AlbShkenca në 26 – 27 shtator 2019. Në këtë mbledhje u realizua dhe prezantimi i projeksionit të aktiviteteve për vitin 2020: Samiti i Grave të Biznesit (18 janar 2020); Takimi i Mjekësisë në Diasporë (20 shkurt 2020); Takimi i Shkrimtarëve në Diasporë (22 shkurt 2020); Takimi i Mësuesve në Diasporë (14 mars 2020); Takimi i Juristëve në Diasporë (4 prill 2020).

21 nëntor

U diskutua mbi hartimin e Programit Shtetëror të Aktiviteteve për Diasporën për vitin 2020 nën koordinimin e Koordinatorës Shtetërore për Programin e Aktiviteteve, znj. Ornela Çuçi. U vlerësua që dokumenti të merrte formën e plotë pas miratimit të ligjit të buxhetit për vitin 2020.

16 dhjetor 2019

Në këtë mbledhje u pasqyrua aktiviteti i bërë nga ky grup koordinatorësh si dhe rezultatet e arritura deri më tani, duke nënvizuar angazhimin e institucional si dhe prezantuar projeksionin e aktiviteteve për vitin 2020.



IV. KOMITETI SHTETËROR PËR DIASPOREN

Komiteti Shtetëror për Diasporën është organ konsultativ i Këshillit të Ministrave për bashkërendimin e politikave e të veprimtarive shtetërore në fushën e diasporës. Ai funksionon mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.690 Datë 22.11.2017. “Për krijimin dhe funksionimin e Komitetit Shtetëror për Diasporën”. Sekretariati teknik i tij funksionon mbi bazën e Urdhërit të Kryeministrit Nr.231, Datë 7.12.2017. Kjo sekretari drejtohet nga përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Diasporës (drejtori ekzekutiv).

Gjatë vitit 2019 si pjesë e punës së Komitetit Shtetëror të Diasporës janë caktuar me urdhër të Kryeministrit për çështje të veçanta Koordinatorët Shtetërorë në nivelin e zëvendësministrit. Ata janë si më poshtë:

1. Me Urdhrin Nr. 43, datë 12.02.2019 të Kryeministrit “Për caktimin e koordinatorit shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit” është caktuar në detyrën e Koordinatorit Shtetëror z. Etjen Xhafaj, zëvendësministër në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
2. Me Urdhrin Nr.44, datë 12.02.2019 të Kryeministrit “Për caktimin e koordinatorit shtetëror për organizimin e programit vjetor të aktiviteteve për diasporën shqiptare” është caktuar në detyrën e Koordinatorës Shtetërore znj. Ornela Çuçi, zëvendësministre në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.
3. Me Urdhrin Nr.45, datë 12.02.2019 të Kryeministrit “Për caktimin e koordinatorit shtetëror për informimin e diasporës” është caktuar në detyrën e Koordinatorit Shtetëror z. Fatjon Hallkaj, drejtor i Programimit dhe Zhvillimit në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).
4. Me Urdhrin Nr. 47, datë 18.02.2019 të Kryeministrit “Për caktimin e koordinatorit shtetëror për programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit” është caktuar në detyrën e Koordinatorit Shtetëror z. Redi Shtino, zëvendësministër në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
5. Me Urdhrin Nr. 78, datë 17.04.2019 të Kryeministrit “Për caktimin e koordinatorit shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e njohjes së lejeve të drejtimit të automjeteve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit” është caktuar në detyrën e Koordinatorit Shtetëror z. Artan Shkreli, zëvendësministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. Me Urdhrin Nr. 92, datë 17.05.2019 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit të punës dhe caktimin e personit përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve



pritëse si dhe në ato ndërkombëtare” është caktuar në detyrën e Koordinatorës Shtetërore znj. Fjoralba Caka, zëvendësministre në Ministrinë e Drejtësisë.

7. Me Urdhrin Nr. 112, datë 30.08.2019 të Kryeministrit “Për caktimin e koordinatorit shtetëror për realizimin e programit “Jam shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe” është caktuar në detyrën e Koordinatorës Shtetërore znj. Lorena Haxhiu, zëvendësministre në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Gjatë vitit 2019 Komiteti Shtetëror për Diasporën ka zhvilluar mbledhjet si më poshtë:

25 janar

Komiteti Shtetëror për Diasporën mbajti mbledhjen e radhës ku Ministri i Shtetit për Diasporën, z.Pandeli Majko prezantoi programin e plotë të Samitit të Dytë të Diasporës, i cili u zhvillua më 28 shkurt – 2 mars. Diskutimet kryesore të Komitetit Shtetëror për Diasporën u përqendruan tek organizimi i aktivitetit të Samitit të Dytë të Diasporës.

20 shkurt

Komiteti Shtetëror për Diasporën u fokusua në detajet teknike të organizimit të Samitit të Dytë të Diasporës më konkretisht: Ministri i Shtetit për Diasporën prezantoi ecurinë e punës;

03 maj

Në këtë mbledhje të Komitetit Shtetëror u prezantuan politikat e institucioneve nga Koordinatorët Shtetëror të emëruar deri në atë periudhë lidhur me fushën e përgjegjësisë të secilit koordinator për zbatimin e masave të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 -2024.

Koordinatori Shtetëror për informimin e Diasporës raportoi për krijimin e seksionit informativ “Diaspora”. Ai informoi se është punuar për ngritjen e infrastrukturës dhe për hedhjen e disa prej të dhënave të ofruara nga pjesëmarrësit e Samitit të Dytë të Diasporës. Pjesë e detyrave në vijim është dhe krijimi i një databaze shtetërore për Diasporën që përmban të dhëna të ndryshme mbi anëtarët e Diasporës shqiptare si sipërmarrësit, mjekët, juristët, mësuesit, etj.

Koordinatori Shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit raportoi lidhur me marrëveshjet për njohjen reciproke të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Marrëveshjet dypalëshe që priten të hyjnë në fuqi janë me Rumaninë, Republikën e Kosovës dhe Konfederatën Zvicerane. Koordinatori Shtetëror, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, raportohet se kanë nisur negociatat për dakordësimin për tekstet e marrëveshjeve me Malin e Zi, Italinë dhe Bullgarinë.

Koordinatori Shtetëror për organizimin e programit vjetor të aktiviteteve për Diasporën prezantoi kalendarin e festave lokale për vitin 2019. Kalendarit turistik përmban aktivitete të ndryshme si panaire të produkteve shqiptare, festa të agroturizmit, artizanatit, kulinarisë e kulturës shqiptare, pjesë e të cilave mund të bëhet edhe Diaspora shqiptare.





Koordinatori Shtetëror për Programet/donorët, të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit ka raportuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën se në zbatim të Masës Nr. 64 të Planit të Veprimit.

17 shtator

Në këtë mbledhje Ministri i Shtetit për Diasporën paraqiti aktivitete e kryera deri në muajin shtator 2019 si dhe prezantoi ecurinë administrative të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën. Në këtë mbledhje u prezantuan aktivitetet e projektuara për vitin 2020, më konkretisht: Samiti i Grave të Biznesit (18 janar 2020); Takimi i Mjekësisë në Diasporë (20 shkurt 2020); Takimi i Shkrimtarëve në Diasporë (22 shkurt 2020); Takimi i Mësuesve në Diasporë (14 mars 2020); Takimi i Juristëve në Diasporë (4 prill 2020).

Në këtë mbledhje informoi Koordinatori Shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e njohjes së lejeve të drejtimit të automjeteve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, z. Artan Shkreli.

Në informimin e Komitetit Shtetëror për Diasporën, zëvendësministrja e drejtësisë znj. Fjoralba Caka si Personi Përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit informoi se Ministria e Drejtësisë po vijon me hedhjen e rekordeve penale të shtetasve shqiptarë të dënuar jashtë Shqipërisë. Të dhënat sillen në mënyrë periodike dhe vullnetarisht në bazë të Nenit 22 të Konventës për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike.

Koordinatori shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, z. Etjen Xhafaj raportoi mbi ecurinë e marrëveshjeve dypalëshe që priten të hyjnë në fuqi, më konkretisht me shtetin rumun, qeverinë e Kosovës, Kanadanë dhe Konfederatën Zvicerrane.

Koordinatori Shtetëror për organizimin e programit vjetor të aktiviteteve për Diasporën shqiptare, znj. Ornela Çuçi raportoi se gjatë periudhës janar – shtator 2019 janë realizuar në total 66 aktivitete të parashikuara në kalendarin e vitit 2019.

V. GRUPET NDERINSTITUCIONALE TE PUNES

Gjatë vitit 2018, në funksion të zbatimit të masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, me urdhër të Kryeministrit janë ngritur disa grupe ndërinstitucionale pune, veprimtaria e të cilëve është ndjekur nga Agjencia Kombëtare e Diasporës. Urdhërat e nxjerë gjatë vitit 2019 për qëllimet e sipërpërmendura janë:

Me Urdhër Nr. 135 datë 13.09.2018 “Për zbatimin e Masës 64 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024” u ngrit grupi ndërinstitucional i punës me



qëllim vlerësimin e numrit të studentëve shqiptarë në universitetet jashtë vendit. Ky grup pune do të vlerësonte edhe kushtet e kthimit në Shqipëri për studentët përfitues të bursave të studimit. Ai do të organizojë e informacionin e të mundësive për punësimin e tyre në vendlindje. Në vijim të takimeve të zhvilluara gjatë vitit 2019, grupi ndërinstitucional i punës vlerësoi:

- Vlerësimin e miratimit me akt nënligjor të modelit të kontratës me kusht kthimin në atdhe, që do të lidhet ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe studentëve të cilët do të studiojnë jashtë Shqipërisë me bursat të cilat do të koordinohen nga shteti shqiptar;
- Domosdoshmërinë e krijimit të një regjistri shtetëror për studentët të cilët studiojnë me bursat e shtetit shqiptar apo bursat që i akordohen shtetit shqiptar.
- Domosdoshmërinë e planifikimit dhe koordinimit nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të bursave të akorduara për komunitetet shqiptare jashtë vendit;

Në vlerësim edhe të informacionit nga ky Grup Pune u miratua nga Kryeministri Urdhri Nr.47, datë 18.02.2019 "Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit".

Me Urdhrin Nr. 136 datë 13.09.2018 "Për zbatimin e masës 51 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024" u ngrit grupi ndërinstitucional i punës, i cili kishte si detyrë vlerësimin dhe koordinimin të informacionit për diasporën në faqet zyrtare të institucioneve shtetërore dhe pasurimin e tyre me informacion në interes të diasporës. Grupi i punës, në vijim të takimeve të tij, vlerësoi:

- Caktimin e një personi përgjegjës (u quajt kordinator për informacionin e diasporës) i cili përcaktohet nga struktura administrative e institucioneve përgjegjëse. Ai do të vlerësojë dhe publikojë informacione për diasporën shqiptare në faqen zyrtare të institucionit ku punon duke bashkëpunuar me Agjencinë Kombëtare të Diasporës. Për formën dhe mirëmbajtjen e këtij informacioni ai bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
- Përmbledhjen në çdo institucion të informacionit për interesat e komuniteteve shqiptare jashtë vendit dhe identifikimin në faqet e tyre zyrtare në kategorinë "Diaspora" me synim standardizimin e informacioneve për diasporën dhe migracionin;
- Rekomandimin për hapjen e rubrikës së "Diasporës" në faqet e ambasadave dhe konsullatave të Republikës së Shqipërisë.

Në vlerësim të informacioneve grupit të punës u miratua Urdhri Nr.45, datë 12.02.2019 i Kryeministrit "Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për informimin e Diasporës". Koordinatori Shtetëror vlerëson dhe koordinon punën për informacionin që publikohet nga institucionet e administratës shtetërore për interesat e komunitetit shqiptar jashtë vendit, si dhe raporton çdo tre muaj në Komitetin Shtetëror për Diasporën për realizimin dhe ecurinë e procesit



Me Urdhrin Nr. 137 datë 13.09.2018 të Kryeministrit “Për zbatimin e masës 15 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024” u ngrit grupi ndërinstitucional i punës i kryesuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT), me detyrën për të hartuar raportin vjetor statistikor për diasporën shqiptare, ku të pasqyrohen të dhënat dhe vlerësimi i shteteve ku duhet vepruar me përparësi nga politikat për diasporën. Grupi i punës në takimin e datës 08.10.2018 dakordësoi për afatet që do të ndiqen në vitin 2019 lidhur me përgatitjen e raportit të dytë të statistikave për diasporën. Gjate 6-mujorit të parë 2019 janë mbledhur të dhënat nga EUROSTAT dhe në vijim është punuar për të mbledhur të dhënat krahasuese nga regjistri i gjendjes civile dhe ato të dërguara nga përfaqësitë diplomatike. Rezultat i takimeve të grupit të punës për vitin 2019 është publikimi i Raportit Vjetor “Diaspora e Shqipërisë në shifra” 2019.

Me Urdhrin Nr. 138 datë 13.09.2018 të Kryeministrit “Për zbatimin e masave 2 dhe 45 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024” u ngrit grupi ndërinstitucional i punës për përgatitjen e Programit Kombëtar Vjetor për aktivitetet e përbashkëta në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë, si dhe të aktiviteteve periodike për turizmin shqiptar dhe mundësitë lidhur me investime në Shqipëri. Agjencia Kombëtare e Diasporës koordinoi punën me institucionet shtetërore që kishin planifikuar aktivitete në interes të diasporës dhe përgatiti dokumentin përfundimtar të Programit Shtetëror të Aktiviteteve për Diasporën Shqiptare, i cili u publikua në muajin shkurt 2019, përpara Samitit të Dytë të Diasporës.

Në vlerësim të informacionit dhe të propozimeve të Grupit të Punës u miratua Urdhri Nr.44, Datë 12.02.2019 i Kryeministrit "Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për organizimin e Programit Vjetor të Aktiviteteve për Diasporën Shqiptare". Urdhri parashikon se Koordinatori Shtetëror, në zbatim të masave 2 dhe 45 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, koordinon e organizon aktivitete në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë, mbi bazën e një programi vjetor si dhe aktivitete të tjera periodike për turizmin shqiptar. Koordinatorë Shtetërore u caktua zëvendësministrja e Turizmit dhe Mjedisit. Në bazë të Urdhrit Nr. 44/2019 Koordinatori Shtetëror raporton çdo tre muaj në Komitetin Shtetëror për Diasporën për realizimin dhe ecurinë e procesit.

Me Urdhrin Nr. 180, datë 26.12.2018 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të punës për përgatitjen e platformës së programeve të emisioneve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, kulturën shqiptare dhe identitetin kombëtar, të dedikuara për diasporën”, u ngrit grupi ndërinstitucional i punës për hartimin e platformës së programeve të emisioneve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe. Grupi i punës në takimet e tij ka diskutuar për domosdoshmërinë për unifikimin e teksteve të gjuhës shqipe. Radiotelevizioni Shqiptar (RTSH) ka konfirmuar se në marrëveshjen e bashkëpunimit me Radiotelevizionin e Kosovës (RTK), është rënë dakord që në emisionet e tyre të përfshijnë tematika për diasporën shqiptare.

Universiteti i Tiranës ka propozuar që programi të jetë i hapur për të gjitha grup-moshat dhe për një lidhje më të mirë të programeve me nevojat e diasporës, ndërsa Ministria Arsimit,



Sportit dhe Rinisë ka ofruar të vëre në dispozicion një listë të përshtatshme të mësuesve që do të përfshihen në transmetimet televizive

Është përgatitur projekti “Fol Shqip” dhe projekti “Krenohem me Ju” për zbatim në përputhje me Vendimin Nr. 690/2018 të Këshillit të Ministrave “Për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore, të dedikuara për diasporën”.

Me Urdhrin Nr. 181, datë 26.12.2018 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për organizimin e punës për të bërë funksional pavijonin e diasporës, në Muzeun Historik Kombëtar” u ngrit grupi ndërinstitucional për organizimin e punës për të bërë funksional pavijonin e veçantë për diasporën, në Muzeun Historik Kombëtar. Grupi i punës realizoi disa mbledhje gjatë vitit 2019 ku u diskutua për realizimin dhe bërjen funksionale të pavijonit të veçantë dedikuar diasporës në Muzeun Historik Kombëtar, në të cilin do të paraqitet historia e Diasporës Shqiptare në mënyrë kronologjike.

Aktualisht është përgatitur relacioni nga Grupi i punës dhe mbetet për plotësim nga ekspertët vlerësimi i kostos financiare për realizimin e këtij pavijoni të posaçëm.

Me Urdhrin Nr. 92, datë 17.05.2019 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit të punës dhe caktimin e personit përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare” u ngrit grupi ndërinstitucional i punës i cili ka përgjegjësinë në koordinimin e punëve ndërinstitucionale për mbledhjen e informacionit të plotë, për ndjekjen dhe trajtimin sipas legjislacionit në vendet pritëse, të shtetasve shqiptarë, të cilët vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë vendit. Sipas Urdhrit të Kryeministrit personi përgjegjës është caktuar zëvendësministrja e drejtësisë.

Me Urdhrin Nr. 124, datë 18.09.2019 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” u ngrit grupi ndërinstitucional i punës për hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Nga grupit ndërinstitucional i punës është përgatitur paketa ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Këto propozime, Ministri i Shtetit për Diasporën i ka përcjellë Kryeministrit dhe Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore në Kuvendin e Shqipërisë.





VI. KESHILLI KOORDINUES I DIASPORES

Këshilli Koordinues i Diasporës është një strukturë e cila funksionon për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar. Misioni i Këshillit Koordinues të Diasporës është mbrojtja dhe forcimi i marrëdhënieve me Diasporën shqiptare duke i mundësuar asaj pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në politikëbërje dhe vendimmarrje me qëllim përfaqësimin e interesave të shqiptarëve të larguar nga vendlindja. Këshilli Koordinues i Diasporës është organi përfaqësues i marrëdhënieve të Diasporës me institucionet shtetërore shqiptare. Në mbledhjet e tij të rregullta marrin pjesë përfaqësuesit më të lartë të institucioneve shtetërore. Ai është ngritur dhe kryen veprimtarinë e tij mbi bazën e Ligjit Nr. 16/2018 “Për Diasporën”. Në përputhje me këtë ligj, Agjencia Kombëtare e Diasporës kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Koordinues të Diasporës.

Këshilli përbëhet nga 15 përfaqësues të Diasporës, të spikatur në fushat e arsimit, shkencës, kulturës, sipërmarrjes, teknologjisë si dhe fusha të tjera, të cilët kanë një kontribut të vazhdueshëm në promovimin e interesave të kombit shqiptar dhe veçanërisht në çështjet e Diasporës shqiptare. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës zgjidhen sipas një procedure të miratuar me Vendim Nr. 340/2018 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës” dhe gëzojnë status të veçantë.

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka koordinuar mbledhjen e propozimeve për kandidatë në Këshillin Koordinues të Diasporës të përcjella nga Ambasadat e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe për verifikimin nëse këto propozime i plotësojnë kriteret e kërkuara nga ligji Nr. 16/2018 “Për diasporën” dhe Vendimi Nr. 340/2018 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës”.

Me Vendimin Nr. 195, datë 05.04.2019 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës”, me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën, u miratuan 15 anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës. Anëtarë të Këshillit Koordinues të Diasporës janë:

Z. Mark Gjonaj, Këshilltar në Bashkinë e Neë York-ut, – përfaqësues nga diaspora e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Z. Visar Tasimi, Themelues i shkollës shqipe në Èaterbury - përfaqësues nga diaspora e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;

Znj. Esmeralda Mosko, Këshilltare bordi e Organizatës së Gruas Shqiptaro-Amerikane “Motrat Qirjazi” - përfaqësues nga diaspora e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;

Znj. Adriana Fishta Bejko, Doktore e shkencave në psikiatri me fokus në përvetësimin e gjuhëve të huaja - përfaqësuese nga diaspora e Kanadasë;





- Z. Ardian Radovicka, Inxhinier, piktor, aktivist - përfaqësues nga diaspora e Kanadasë;
- Z. Lazim Destani, Biznesmen - përfaqësues nga diaspora e Gjermanisë;
- Z. Sokrat Sinaj, Profesor - përfaqësues nga diaspora e Zvicrës;
- Z. Ardian Lekaj, Biznesmen, aktivist dhe mbështetës i komuniteteve shqiptare jashtë vendit - përfaqësues nga diaspora e Holandës;
- Z. Rosario Petta, Kryetar Bashkie në “Piana dei Albanesi”, - përfaqësues nga diaspora e Italisë;
- Znj. Anila Hyka Smorgrav, Profesioniste në fushën e IT dhe Telekomit - përfaqësues nga diaspora e Francës;
- Z. Gazmend Kapllani, Shkrimtar, Profesor, Drejtues i Katedrës së Albanologjisë - përfaqësues nga diaspora e Greqisë;
- Z. Namik Shabi, Kryetari i shoqatës “Vatra” - përfaqësues nga diaspora e Turqisë;
- Z. Bashkim Bekiri, Kryetar i Shoqatës së Komunitetit Shqiptaro –Australian - përfaqësues e diasporës së Australisë;
- Znj. Brikena Muharremi, Avokate – përfaqësuese e diasporës së Britanisë së Madhe;
- Z. Endri Hatillari, Eksperiencia profesionale menaxheriale, aktivist – përfaqësues nga diaspora e Britanisë së Madhe.

Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës gëzojnë një status të veçantë, të përcaktuar me Vendimin Nr. 320, datë 15.05.2019 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës”. Anëtarët, në funksion të përmbushjes së detyrave të tyre, kanë të drejtë të kërkojnë informacion në fushat e përgjegjësisë së institucioneve shtetërore përgjegjëse, të propozojnë akte administrative, të marrin pjesë në seanca dëgjimore në Komitetin Shtetëror të Diasporës ose në Komisionet e Kuvendit të Shqipërisë për çështje që kanë të bëjnë me interesat e Diasporës shqiptare dhe bashkëpunimit e kontributit të saj për zhvillimin e vendit.

Në Ditën Kombëtare të Diasporës, në datë 18 dhjetor 2019 u zhvillua mbledhja e parë zyrtare e Këshillit Koordinues të Diasporës në Tiranë. Në këtë mbledhje morën pjesë përfaqësuesit më të lartë shtetërorë: Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Kryetarja e Komisionit për Politikën e jashtme në Kuvendin e Shqipërisë, anëtarë të Këshillit të Ministrave dhe drejtues të institucioneve kryesore në vend. Në këtë mbledhje u zgjodhën organet drejtuese të Këshillit Koordinues të Diasporës ku u zgjodhën si kryetar i Këshillit Koordinues të Diasporës z. Mark Gjonaj, Nënkryetare znj. Anila Hyka Smorgrav dhe Sekretare znj. Adriana Fishta Bejko. Këshilli me vendim miratoi Rregulloren e funksionimit të Këshillit Koordinues të Diasporës.



Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës diskutuan me anëtarët e kabinetit qeveritar mbi pjesëmarrjen aktive të diasporës në politikat shtetërore në fushën e ekonomisë, arsimit, kulturës, bujqësisë. Në këtë takim u diskutua mbi rolin e diasporës në rikuperimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26 nëntor. Gjithashtu, anëtarët e Këshillit vizituan familje të prekura nga tërmeti duke shprehur mbështetjen e tyre.

Me këtë takim u mor vendimi për zëvendësimin e fjalës Samit me fjalën shqipe “Kuvend” si dhe u vendos për ngritjen e grupit të punës për organizimin e “Kuvendit të Diasporës”. Anëtarët e Këshillit Koordinues zhvilluan takime edhe me personalitete të tjera shtetërore si Kryetarin e Kuvendit, Kryetarin e Bashkisë Tiranë dhe faktorë të tjerë politikë të shtetit shqiptar.

VII. AMBASADORET E KOMBIT

Në zbatim të ligjit Nr. 16/2018 “Për diasporën”, për pjesëtarët e suksesshëm të diasporës shqiptare akordohet çmimi “Ambasador i Kombit”. Dhënia e këtij çmimi udhëhiqet nga parimet e vlerësimit të kontributit, meritokracisë, transparencës dhe mirënjohjes publike.

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka punuar për koordinimin dhe mbledhjen e propozimeve të përcjella nga Ambasadat e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për dhënien e çmimit “Ambasador i Kombit”, si dhe të dokumenteve shoqëruese të këtyre propozimeve, sipas Vendimit Nr. 339/2018 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së çmimit “Ambasador i Kombit”. Me Urdhrin Nr. 50, datë 27.02.2019 Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën, miratoi listën e personave të suksesshëm të diasporës të cilëve iu akordua çmimi “Ambasador i Kombit”. Për dhënien e çmimit u organizua një ceremoni e veçantë gjatë ditëve të zhvillimit të Samitit të Dytë të Diasporës.

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në zbatim të masës Nr. 40 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, ka krijuar Rrjetin e Ambasadorëve të Kombit.

VIII. SAMITI I DYTE I DIASPORES

Samiti i Dytë i Diasporës Shqiptare u zhvillua në datat 28 shkurt - 2 mars 2019 dhe mikpriti përfaqësues të komuniteteve shqiptare në mbarë botën, përfaqësues të shoqatave shqiptare, si dhe personalitete shqiptare të spikatura të biznesit, shkencës, artit dhe kulturës që jetojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre jashtë vendit. Ky Samit mundësoi një hapësirë diskutimi për çështje të ndryshme të politikëbërjes së shtetit shqiptar, përfshirë qasjen e re të institucioneve shtetërore ndaj bashkëpunimit me diasporën dhe njëkohësisht këndvështrimin e diasporës duke evidentuar sukseset e arritura dhe vështirësitë e hasura gjatë këtij bashkëpunimi.



8.1 PJESËMARRJA NE SAMITIN E DYTE TE DIASPORES

Samiti i Dytë i Diasporës Shqiptare mbledhi mbi 1400 pjesëmarrës nga 25 vende të ndryshme të botës.

Samiti i Dytë i Diasporës ishte një aktivitet i hapur për pjesëmarrës nga e gjithë hapësira shqiptare. Pjesëmarrja në Samit ishte e lirë me krijimin e mundësive të regjistrimit online. Në faqen web të Samitit të Dytë të Diasporës (www.samiti.diaspora.gov.al) të hapur posaçërisht për informimin e diasporës mbi këtë event të rëndësishëm, mund të bëhej regjistrimi online si një formë shprehjeje interesi për pjesëmarrje.

Për marrjen e ftesës online kërkohej plotësimi i të dhënave të përgjithshme të individit, si vendi i lindjes, rezidenca dhe kontaktet. Të gjitha këto të dhëna u përpunuan në përputhje me parashikimet ligjore për ruajtjen e të dhënave personale. Në formularin e regjistrimit, çdo i interesuar kishte mundësinë të shprehte interesin për të ndjekur diskutimin në një nga panelet që i përshtatej më mirë fushës së interesave të tij. Menjëherë pas aplikimit online, çdo aplikues merrte një konfirmim dhe Ftesën Elektronike së bashku me detajet e organizimit të aktivitetit.

Në këtë aktivitet mbarëkombëtar gjithashtu u ftuan personalitete të njohura të Diasporës, përfaqësuesit e organizatave dhe shoqatave që veprojnë në Diasporë dhe individë me një histori sukcesi në vendet ku jetojnë. Samiti i Dytë i Diasporës mori një vëmendje të veçantë dhe nga aktorët kryesorë të politikëbërjes në Shqipëri, Kosovë, në trevat shqiptare në Maqedoninë e Veriut, Malit të Zi dhe trevat shqiptare në Serbi, ku përfaqësuesit më të lartë shtetërorë morën pjesë dhe shprehën gatishmërinë e tyre për një intensifikim dhe bashkëpunim të ngushtë midis tyre, duke e vendosur çështjen e diasporës si prioritetet në axhendat e përbashkëta.

8.2 PANELET E DISKUTIMIT GJATE SAMITIT

Në datë 1 mars 2019 u organizua Sesi i Kryesor i Samitit të Dytë të Diasporës në ExpoCity ku pjesëmarrësit patën mundësinë të marrin pjesë në diskutimet e zhvilluara në katër panele:

Paneli I: “Vota si e drejtë! - Politika e re shtetërore për Diasporën” (Diaspora dhe të drejtat e saj në vendlindje)

Çështjet kryesore të diskutuara u fokusuan në: Diskutime mbi mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve shqiptare të Diasporës; Garantimin e të drejtave politike dhe në veçanti i të drejtës së votës së shtetasve shqiptarë jashtë atdheut, pjesëmarrja në votime në shtetin e tyre të origjinës; Miratimin e ligjit që parashikon marrjen e masave koordinuese për realizimin e të drejtës së votës së Diasporës me shtetësi shqiptare në zgjedhje; Rëndësinë e materialit mbi votimin e shtetasve shqiptarë jashtë vendit; Mbrojtjen dhe gëzimin “de facto” i të drejtave kushtetuese nga migrantët, masat shtesë që mund të marrin organet shtetërore; Diskutimin



mbi të drejtat e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, për pjesëmarrje më aktive në zhvillimet e vendit amë.

Paneli II: “Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm - "Vendlindja dhe Diaspora” (Ekonomia, Remitancat, Sipërmarrja)

Çështjet kryesore të diskutuara u fokusuan në: diskutime për institucionet dhe zbatimin e politikave që synojnë nxitjen e investimeve dhe kanalizimin e dërgesave të emigrantëve me institucionet financiare në vendet pritëse; remitancat dhe politikat nxitëse bankare për Diasporën shqiptare; kalimi i dërgesave të migrantëve nga rrugët informale të transferimit në ato formale; lehtësimi i tërheqjes së investimeve nga sipërmarrës të Diasporës; nxitja dhe fuqizimi i rrjeteve të biznesit në Diasporë dhe i shkëmbimit të informacionit me qëllim shfrytëzimin e potencialit ekonomik që Diaspora mbart në vetvete, në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Paneli III: “Identiteti shqiptar - E ardhmja fillon nga Diaspora!” (Arsimi, Kultura, Arti dhe Filantropia si cilësi komunitare)

Çështjet kryesore të diskutuara u fokusuan në: diskutimi i ndryshimeve ligjore të kryera dhe marrëveshjeve midis Shqipërisë dhe Kosovës në këtë fushë; Kultura dhe programet e reja për ruajtjen e identitetit shqiptar; mësimi i gjuhës shqipe si çështje me përparësi për Diasporën shqiptare dhe për vazhdimësinë e identitetit gjuhësor; krijimi i Qendrës së Botimeve për Diasporën dhe tekstet që do të shërbejnë për mësimin e gjuhës shqipe; projekti e-book nëpërmjet të cilit mundësohet shkarkimi online i teksteve shkollore të vendosura në programin arsimor për Diasporën; krijimi i Qendrave Kulturore, të cilat kanë si mision ruajtjen, kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të Diasporës dhe forcimin e lidhjeve të saj me institucionet e Republikës së Shqipërisë; Modelet e filantropisë për këtë fushë dhe mundësitë e bashkëpunimit.

Paneli IV: “Ftesë nga shtëpia juaj” (Turizëm, Agroturizëm)

Çështjet kryesore të diskutuara u fokusuan në diskutimin mbi mundësitë turistike të zonës rurale. Vendosja e fokusit në investimet që kanë si synim transformimin rrënjësor të zonave rurale duke i kthyer në potencial turistik. Diskutimi i projektit “100 fshatrat” si pjesë e Programit të Integruar për Zhvillimin Rural. Diskutim mbi eksperiencat e vendeve të Evropës, të përparuara në këtë drejtim, me qëllim realizimin e objektivave. Ofrimi i mundësive ekonomike në hapësirën rurale dhe tërheqja e turistëve.

Gjatë Samitit pjesëmarrësit patën mundësinë të paraqesin projekte dhe propozime konkrete për krijimin dhe fuqizimin e lidhjeve mes Shqipërisë dhe vendeve pritëse, si edhe shkëmbimin e eksperiencave me qëllim rritjen e kontributit të Diasporës në zhvillimin ekonomik, shoqëror e kulturor të vendit. Samiti i Dytë i Diasporës synoi gjithashtu fuqizimin e ndjenjës së identitetit dhe vlerave kombëtare të shqiptarëve kudo ata jetojnë.



8.3 AKTIVITETE GJATE SAMITIT TE DYTE TE DIASPORES

Në datën 28 shkurt 2019, në Pallatin e Brigadave u organizua një ceremoni mirëpritjeje ku morën pjesë autoritetet më të larta shtetërore.

Në datën 1 mars 2019 në Pallatin e Kongreseve u organizua Mbrëmja Gala ku u akorduan çmimet “Shqiponja e Artë” dhe disa prej çmimeve “Ambasador i Kombit” për individë dhe shoqata, të cilët kontribuojnë në ruajtjen dhe promovimin e kulturës dhe gjuhës shqipe.

Një ceremoni e veçantë për ndarjen e çmimit “Ambasador i Kombit” u zhvillua në datën 2 mars nga Ministri i Shtetit për Diasporën në ambientet e Kryeministrisë. Këto çmime iu dhanë disa prej aktivistëve më të spikatur të komuniteteve shqiptar në botë. Të integruar në vendin ku jetojnë, por po aq të dedikuar ndaj ruajtjes së gjuhës, kulturës dhe traditës shqiptare, këta individë punojnë vazhdimisht me qëllim ruajtjen e vlerave dhe traditave tek brezat dytë dhe të tretë të fëmijëve të familjeve shqiptare në botë.

Samiti i Dytë i Diasporës u organizua në datat 28 shkurt – 2 mars pasi kjo datë e fundit përkon me 575 vjetorin e Besëlidhjes së Lezhës. Edhe për këtë arsye, në datën 2 mars u organizua veprimtaria përmbyllëse e Samitit të Dytë të Diasporës në sheshin “Gjergj Kastrioti” në Lezhë. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të lartë shtetëror si Presidenti i Republikës, Ministri i Shtetit për Diasporën dhe autoritetet vendore. Me rastin e kësaj ngjarje historike për shtetin shqiptar Presidenti i Republikës shpërndau disa tituj nderi ndaj përfaqësuesve më të denjë të Diasporës Shqiptare. Aktiviteti i datës 2 mars u organizua në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë, në nder të ceremonisë së 575 vjetorit të Besëlidhjes së Lezhës, ngjarje kjo me rëndësi të veçantë për këtë qytet.

8.4 TRANSPARENCA E SHPENZIMEVE TE SAMITIT

Gjatë dhe pas organizimit të Samitit të Dytë të Diasporës u hartuan disa materiale me qëllim informimin e publikut. Revista Elektronike “Vendimmarrja dhe transparenca”, është një ndër materialet i cili pasqyroi procesin e vendimmarrjes për organizimin e Samitit, përfshirë aktet ligjore, procesin e pjesëmarrjes dhe dërgimit të ftesave, procesin e regjistrimit të pjesëmarrësve etj.

U publikuan të gjitha aktet ligjore lidhur me buxhetin dhe dokumntacioni për organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës Shqiptare.

Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën, miratoi Vendimin Nr.194, datë 05.04.2019 “Për kthim fondi në buxhetin e shtetit” Sipas këtij vendimi, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare e cila menaxhoi fondet për Samitin e Dytë të Diasporës Shqiptare ktheu në buxhetin e shtetit, shumën prej 14 561 598 (katërmëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) lek të kursyer nga shpenzimet e parashikuara për këtë aktivitet.



IX. RAPORTIM I DREJTORISE SE DIASPORES

9.1 AKTIVITETET E AGJENCISE KOMBETARE TE DIASPORES

Drejtoria e Diasporës, në përputhje me ligjin Nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, punoi për organizimin e aktiviteteve në kuadër të ruajtjes dhe promovimit të gjuhës, kulturës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare në diasporë, si dhe në zbatimin e programeve të veçanta për këtë qëllim. Organizimet e zhvilluara gjatë vitit 2019 janë miratuar me Vendimin Nr. 3, datë 26.08.2019 dhe Vendimin Nr. 4, datë 05.11.2019 të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

9.2 AKTIVITETET PER KOMUNITETIN SHQIPTAR NE UKRAINE

Agjencia Kombëtare të Diasporës përgatiti një program të veçantë kushtuar shqiptarëve të Ukrainës, të cilët edhe pse pa komunikim prej shekujsh me vendin e origjinës, e kanë ruajtur me shumë fanatizëm origjinën, kulturën, gjuhën dhe traditën shqiptare. Drejtoria e Diasporës e filloi programin e saj me zonën e Karakurtit dhe Zaporozhye-s, aty ku gjendet komuniteti shqiptar në Ukrainë. Gjatë vitit 2019 janë kryer aktivitetet e mëposhtme:

Karakurt, Ukrainë, 5 – 6 maj

Në datat 5 dhe 6 maj 2019 Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko dhe Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës zhvilluan një vizitë zyrtare në Karakurt, Ukrainë, me rastin e festës së Shën Gjergjit. Kjo festë përkon dhe me nderimin që diaspora e Ukrainës i bën heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Në këtë vizitë zyrtare, Agjencia Kombëtare e Diasporës dhuroi 20 kostume popullore, spila, 100 fletore pune, 150 libra për fëmijë në gjuhën shqipe dhe 100 abetare në shenjë falenderimi për ruajtjen e identitetit dhe kulturës shqiptare me dëshirën për ndihmesën në ruajtjen në vazhdimësi të identitetit kombëtar. Gjatë kësaj vizite, për herë të parë u prezantua programi i Agjencisë Kombëtare të Diasporës për ruajtjen e gjuhës shqipe, kulturës dhe identitetit kombëtar në diasporë.

Ministri i Shtetit për Diasporën ishte i ftuar në një forum diskutimi në Universitetin Shtetëror në qytetin Izmail, ku foli për bashkëpunimin mes dy vendeve. Të pranishëm në forum ishin jo vetëm studentë shqiptarë, por edhe studentë ukrainas, të cilët studiojnë gjuhën, kulturën dhe traditat shqiptare.

Shqipëri, 2 – 6 qershor

Një grup nxënësish shqiptarë nga Karakurti, Ukrainë zhvilluan një vizitë njohëse me synimin për të njohur vendin e të parëve të tyre. Aktiviteti u koordinua nga Agjencia Kombëtare e



Diasporës. Një pritje e veçantë për ta u realizua nga Ministri i Shtetit për Diasporën. Fëmijët u shoqëruan në Muzeun Historik Kombëtar, ku u njohën me historinë, kulturën, trashëgiminë kulturore dhe personalitetet e rëndësishme të historisë shqiptare. Agjencia Kombëtare e Diasporës dhuroi për nxënësit shqiptarë suvenire simbolike në formë kujtese për udhëtimin e tyre të parë në Shqipëri.

Karakurt, Ukrainë, qershor - korrik

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr. 166/1 Prot., datë 15.05.2019 me Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor Kombëtar të Këngëve dhe Valleve¹, si dhe në kuadër të programit për ruajtjen e gjuhës shqipe, kulturës dhe identitetit kombëtar në diasporë, Agjencia Kombëtare e Diasporës dërgoi dy grupe valltarësh, koreografësh dhe instrumentistësh në Karakurt, Ukrainë për mësimin e këngëve dhe valleve shqiptare. Grupi i parë zhvilloi një kurs të mësimin të këngëve dhe valleve shqiptare për komunitetin shqiptar në Karakurt në datat 27 qershor deri më 5 korrik dhe grupi i dytë në datat 4 korrik deri më 12 korrik 2019. Pjesë e këtyre kurseve ishin pjesëtarë të komunitetit shqiptar në Ukrainë, kryesisht nga Karakurti dhe Izmailov.

Zaporozhye, Ukrainë, 10 – 13 shtator

Në datat 10 – 13 shtator 2019 përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilluan një vizitë pune në Zaporozhye, Ukrainë. Gjatë kësaj vizite ata janë takuar me zëvendësgubernatorin e rajonit të Zhaparozhye në Ukrainë, z. Gygnii Eduard Anatolievich. Në këtë takim u diskutua për mundësinë e shtimit të kurseve të valleve dhe këngëve shqiptare në këtë rajon të Ukrainës. Përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Diasporës parashtruan edhe mundësinë e bashkëpunimit mes dy palëve me qëllim rehabilitimin e qendrave kulturore të fshatrave në këtë rajon pasi që një pjesë e fshatrave të këtij rajoni janë të banuara me shqiptarë.

Gjatë kësaj vizite në Ukrainë u firmos Memorandumi i Bashkëpunimit me Institucionin edukativo-arsimor “Azimuth” në Priazov. Ky memorandum synon bashkëpunimin ndërinstytucional dhe edukimin e brezave të rinj për gjuhën, historinë dhe traditat shqiptare përmes organizimit të aktiviteteve të ndryshme në Ukrainë. Një ndër prioritetet është hapja e klasave për mësimin plotësues të gjuhës dhe kulturës shqipe për fëmijët e komunitetit shqiptar në këtë rajon. Gjithashtu memorandumit parashikon shkëmbimin arsimor të stafit pedagogjik me qëllim që mësuesit nga Ukraina të kryejnë studime të specializuara për gjuhën, literaturën dhe historinë shqiptare në Universitetin e Tiranës. Agjencia Kombëtare e Diasporës është angazhuar në monitorimin dhe zhvillimin e këtij bashkëpunimi.

Zaporozhye, Ukrainë, 2 – 10 tetor

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr. 166/1 Prot., datë 15.05.2019 me Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve, si dhe në kuadër të programit për ruajtjen e gjuhës shqipe, kulturës dhe identitetit kombëtar në diasporë, Agjencia Kombëtare e Diasporës dërgoi një grup valltarësh dhe instrumentistësh në

¹ Aneks Marrëveshjes Nr. 166/2 Prot., datë 15.05.2019



Zaporozhye, Ukrainë për mësimin e këngëve dhe valleve shqiptare për komunitetin shqiptar. Ky program u shtri në disa zona të Zaporozhye si Gamovka, Divnyns'ke dhe Tyushki etj. Një aktivitet i rëndësishëm përkoi me ditën e pensionistëve ku valltarët profesionistë të Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve iu mësuan të pranishmëve vallet tradicionale shqiptare.

Odessa, Ukrainë, 31 tetor

Në vijim të organizimit të klasave të mësimin të valleve dhe kulturës shqiptare për komunitetin shqiptar në Karakurt, Tyushki, Divnyns'ke dhe Gamovka, në datë 31 tetor 2019 Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve dhe pjesëtarë të komunitetit shqiptar vendas u ngjytën mbrëmjen e së enjtes, 31 tetor 2019, në skenën e Teatrit Akademik të Komedisë Muzikore në Odessa me një repertor të larmishëm tradicional, në një koncert të dedikuar për komunitetin shqiptar në Ukrainë. Ky koncert u organizua nga Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Teatrin e Operas, Baletit dhe Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve si një aktivitet përmblyllës i projektit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për mësimin e këngëve dhe valleve shqiptare për komunitetet shqiptare në Ukrainë për vitin 2019.

Karakurt, Ukrainë, 4 – 11 nëntor

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në përputhje me misionin e saj për ofrimin e ndihmës për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare, filloi zbatimin e programit “Të mësojmë gjuhën shqipe në diasporë” në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ky program synon evidentimin e njohurive të gjuhës shqipe në komunitetet shqiptare të Diasporës dhe krijimin e një programi të posaçëm për secilin komunitet sipas shkallës së njohjes së gjuhës shqipe. Për herë të parë, në datat 4 – 11 nëntor 2019 dy mësuese të gjuhës shqipe zhvilluan kurse të mësimin të gjuhës shqipe për fëmijët e komunitetit shqiptar në Karakurt. Ky projekt u shtri edhe në qytezat Gamovka, Divnyns'ke dhe Tyushki.

9.3 AKTIVITETE PER KOMUNITETIN SHQIPTAR NE ITALI

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka përgatitur një program të veçantë kushtuar shqiptarëve të Italisë, si për diasporën e hershme (arbëreshët), ashtu edhe për diasporën e re. Ky program synon të ruajë gjuhën, kulturën, traditat kombëtare dhe të forcojë lidhjen e vendit të origjinës dhe vendit pritës. Përmes vizitave dhe aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2019, Agjencia Kombëtare e Diasporës krijoi kontakte të drejtpërdrejta me komunitetin shqiptar në Itali dhe u njoh me nevojat kryesore të tyre.

Romë, Itali, 14 – 17 shkurt

Në datat 14 – 17 shkurt 2019 Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Diasporës shoqëroi Ministrin e Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko në kuadër të takimeve me rrjetin e Avokatëve dhe përfaqësuesit të studentëve shqiptarë në Romë. Në këtë takim pati diskutime të shumta mbi situatën e shqiptarëve në Itali dhe rrjetëzimin e shqiptarëve në vendin fqinj. Në fund të takimit, përfaqësuesit e rrjetit të avokatëve i dhuruan ministrit librin “Politikat



shtetërore për Diasporën”, të përkthyer në italisht në mënyrë vullnetare nga anëtarët e rrjetit të avokatëve shqiptarë në Itali.

Gjatë kësaj vizite, Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko u takua me përfaqësues të Konfederatës Kombëtare të Zejtarisë (KKZ). Të dy palët diskutuan mbi koordinimin dhe bashkëpunimin në fushën e sipërmarrjes dhe tregtisë, si një mjet i rëndësishëm për të nxitur investimet dhe për të forcuar marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Italisë. Gjithashtu gjatë këtij takimi u diskutuan detajet konkrete për krijimin e Dhomës së Tregtisë për Diasporën Shqiptare në Itali (DHTDSHI), e cila në bashkëpunim me Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës do të jetë një pikë mbështetëse për biznesin e vogël dhe të mesëm të krijuar nga shqiptarët e vendosur në Itali.

Gjithashtu, Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Diasporës morën pjesë në Konferencën me temë *“Diaspora shqiptare, pikënisje për formimin dhe zhvillimin e Europës”*, organizuar nga “Integra Onlus” dhe Fondacioni “Ura për të ardhmen”. Gjatë këtij takimi u diskutuan tema si: roli i Diasporës si urë lidhëse mes vendeve dhe kulturave të ndryshme; rëndësia e dialogut social dhe fetar me qëllim krijimin e një vizioni të përbashkët, në dobi të integritimit të popujve në një perspektivë të përbashkët evropiane.

Romë, Itali, 10 – 11 mars

Në datë 11 mars 2019, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko morën pjesë në Konferencën *“Minoranca Arbëreshe, feja, kultura, tradita” në Romë*. Konferenca u organizua në kuadër të “100 vjetorit të institutit të Eparkisë së Lungros”. Në fjalën e tij ministri u ndal tek historia e komunitetit arbëresh, pjesë e pandarë e kombit shqiptar dhe mbi të gjitha pjesë thelbësore e historisë sonë.

Chieuti, Itali, 17 – 19 maj

Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare për Diasporën mori pjesë në ceremoninë e inaugurimit të bustit të heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu në komunën e Chieuti, Itali në kuadër të zbatimit të misionit të kësaj agjencie në ruajtjen e vlerave kombëtare dhe forcimin e komuniteteve shqiptare në botë. Në këtë aktivitet u përurua dhe botimi i abetares në gjuhën arbëreshe nga studiuesi Prof. Mario Massaro në bashkëpunim me znj. Ariana Balluku. Gjatë këtij aktiviteti, një grup nxënësish të shkollës shqipe “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” interpretuan këngë dhe valle me motive arbëreshe.

Vatikan, Itali, 24 – 25 maj

Përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko morën pjesë në audiencën e veçantë që Papa Françesku mbajti në Vatikan me rastin e 100 vjetorit të themelimit të Eparkisë së Ungros. Në fjalën e tij Papa i cilësoi arbëreshët si dëshmitarë të vërtetë të vëllazërisë mes popujve, duke vlerësuar si të veçantë dhe unik rrugëtimin e tyre ndër shekuj. Në këtë ngjarje të rëndësishme për komunitetin



arbëresh ishin të pranishëm dhe kandidatët italo-shqiptarë në zgjedhjet lokale dhe ato evropiane që u zhvilluan më 26 maj 2019.

Santa Caterina Albanese, Itali, 31 maj – 2 qershor

Përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Diasporës morën pjesë në Shfaqjen e XXVI kulturore folklorike në nder dhe me pjesëmarrjen e pakicave etnike, në komunën Santa Caterina Albanese, në Kalabri të Italisë. Në rajonin e Kalabrisë ndodhet një numër i konsiderueshëm komunash arbëreshe me një jetë shoqërore dhe kulturore të larmishme. Aktivitetet e tyre synojnë ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe traditave në komunitetin arbëresh, veçanërisht tek fëmijët. Konferenca e sivjetshme iu kushtua shkrimtarit të njohur arbëresh Francesco Antonio Santori. Në Konferencë morën pjesë personalitete arbëreshe, si Prof. Cettina Mazzei, Ambasadore e Kombit dhe organizatore e aktivitetit; kryebashkiakët e komunave Santa Caterina Albanese dhe Cerzeto, z. Lavallo dhe z. Rizzo; albanologët e njohur Altimari dhe Mandalà dhe dhjetëra përfaqësues të komunitetit arbëresh. Nxënësit e shkollave arbëreshe të Kalabrisë zhvilluan një konkurs mbi krijimtarinë e Santorit. Në përfundim të konferencës, u ndanë çmime për nxënësit dhe interpretuesit më të spikatur.

Piana degli Albanesi, Itali, 5 shtator

Për herë të parë Agjencia Kombëtare e Diasporës me mbështetjen e Ministrisë së Shtetit për Diasporën organizoi koncertin "Nëna Arbëri" për të nderuar kujtimin e Nënë Terezës me rastin e përvjetorit të shenjtërimit të saj. Ky koncert me përmasa ndërkombëtare u zhvillua më 5 shtator 2019 në sheshin "Vittorio Emanuele", Piana Degli Albanesi, Palermo Itali.

Përpara publikut tre virtuozët e muzikës shqiptare soprano Inva Mula, violinisti Olen Çezari dhe kompozitori Genc Tukiçi, si dhe artistë të tjerë italianë ofruan një repertor të pasur muzikor. E pranishme në këtë mbrëmje drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Diasporës shprehu mirënjohjen për mikpritjen nga publiku i komunës së Piana degli Albanesi dhe nënvizoi mbi të gjitha bashkëpunimin e tyre për të organizuar një koncert me përmasa të tilla.

Otranto, Itali, 19 tetor

Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Muzeun Historik Kombëtar "Polo Biblio Museale" të Puglias, shoqatën "Integra Solidale", Komunën e Otrantos dhe nën kujdesin e Ministrisë së Shtetit për Diasporën organizoi aktivitetin kulturor "*Fustanella – Ura lidhëse e Adriatikut*" në Otranto, Itali. Ky aktivitet etno-kulturor me Arbëreshët e Italisë kish për qëllim analizimin e elementëve kulturorë, antropologjikë, historikë e folklorikë, duke synuar evidentimin e veçorive dhe ngjashmërive tek kostumet popullore, veçanërisht tek Fustanella.

Programi i këtij aktiviteti përfshinte një gamë të gjerë aktivitetesh e prezantimesh, duke përfshirë kumtesën e studiuesve etnografë nga Shqipëria dhe përfaqësuesve të komunitetit të Piana degli Albanesi, komunitetit arbëresh të Kalabrisë, komunitetit të Bazilikatës dhe të San



Marzano di San Giuseppe, prezantimin e veshjeve tradicionale dhe valleve popullore shqiptare, të zakoneve shqiptare dhe valleve të arbëreshëve në Itali, si dhe kostumeve dhe valleve tradicionale të Salentos.

Aktiviteti vijoi me koncertin me muzikë tradicionale arbëreshe (motive Arbëresh) për t'u mbyllur në mbrëmje me një performancë nga Ansambli i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm anëtarë të përfaqësive diplomatike shqiptare në Itali, përfaqësues të komuniteti arbëresh të Piana degli Albanesi dhe San Marzano di San Giuseppe, Acquafredda, Cosenza si dhe artistë shqiptarë.

9.4 AKTIVITETE PER KOMUNITETIN SHQIPTAR NE KROACI

Agjencia Kombëtare e Diasporës përgatiti një program të veçantë për komunitetin shqiptar në Kroaci me qëllim ruajtjen e gjuhës dhe vlerave kulturore kombëtare të arbëreshëve në Zarë. Duke u nisur nga numri i lartë i shqiptarëve që jetojnë në Zarë, Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilloi gjatë vitit 2019 program për mësimin e gjuhës shqipe për fëmijët shqiptarë atje, si dhe realizoi disa vizita me komunitetin shqiptar.

Zarë, Kroaci, 28 – 30 gusht

Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Diasporës zhvilloi një takim pune në Kroaci me përfaqësuesit e shtetit kroat për Diasporën. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi për bashkëpunim institucional për çështjet e Diasporës dhe mbështetjen e komunitetit shqiptar në Kroaci, në veçanti Arbëreshëve të Zarës, të cilët përbëjnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore. Gjatë bashkëbisedimit, drejtoresha e Agjencisë njohu homologët kroat me politikën shtetërore të hartuara për Diasporën, misionin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, projektet e realizuar nga ky institucion dhe bashkëpunimin me komunitet shqiptarë në Diasporë për ruajtjen e identitetit kombëtar.

Në kuadër të bashkëpunimit institucional përfshihet mësimi i gjuhës dhe kulturës shqiptare dhe realizimi i një projekti pilot me mësues të gjuhës shqipe të cilët do të identifikojnë nevojat e duhura për t'u ardhur në ndihmë nxënësve të këtij komuniteti. Në bazë të marrëveshjes së Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Teatrit të Operas dhe Baletit përfshihet edhe organizimi i seminareve për mësimin e valleve dhe këngëve popullore shqiptare në Kroaci. Përveç kësaj u diskutua edhe për projekte dhe mundësi të tjera bashkëpunimi mes dy vendeve.

Takime pune u zhvilluan dhe me përfaqësues të komuniteteve shqiptare në Zarë, së bashku me Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kroaci. Në takimin me Prof. Dr. Maximiljana Barancic, autore dhe kryetare e shoqatës "Vicko Zmajeviq", u diskutua mbi mundësitë e bashkëpunimit me komunitetin arbëresh për ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore që ky komunitet ka ruajtur ndër shekuj. Gjithashtu, u zhvillua takim me z. Anton Dedaj, kryetar i Këshillit të qytetit të Zarës, dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit. Gjatë takimit u diskutua



për rëndësinë e bashkëpunimit për ruajtjen dhe përhapjen e gjuhës dhe kulturës shqipe në komunitetin shqiptar në këtë qytet, ku jetojnë rreth 3000 banorë me origjinë shqiptare.

Zarë, Kroaci, 2 – 10 nëntor

Sipas programit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për mësimin e gjuhës shqipe për komunitetin shqiptar në Kroaci, si dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, në datat 02 - 10 nëntor 2019 mësuesit nga Shqipëria filluan për herë të parë mësimin e gjuhës shqipe për fëmijët e komunitetit shqiptar në Kroaci. Dy mësuesit nisën punën me një vizitë në shkollën 8-vjeçare "Krone Kristica", në Zara, ku u njohën me kurrikulën mësimore të gjuhës shqipe e cila zbatohet nga mësuesit atje. Janë më shumë se 50 fëmijë të komunitet shqiptar të grup moshave të ndryshme, të cilët çdo të shtunë zhvillojnë mësim plotësues për mësimin e gjuhës shqipe, ndërsa me mbërritjen e mësuesve nga Shqipëria zhvilluan një program më intensiv.

Zarë, Kroaci, 14 nëntor

Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Teatrin Migjeni të Shkodrës organizuan dhënien e shfaqjes teatrale "Zona e pritjes" në skenën e Teatrit Kombëtar të Zarës. Ky bashkëpunim u realizua në bazë të Marrëveshjes Nr. 485 Prot., datë 07.10.2019 me Teatrin "Migjeni" dhe Aneks Marrëveshjes Nr. 485/1 Prot., datë 15.10.2019.

Zarë, Kroaci, 27 dhjetor

Në datë 27 dhjetor 2019, Agjencia Kombëtare e Diasporës organizoi një koncert për komunitetin shqiptar në Zarë të Kroacisë, me artistët e mirënjohur shqiptarë, Inva Mula, Genc Tukiçi dhe Olen Çezari. Përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Diasporës shprehën mirënjohjen për komunitetin shqiptar në Zarë, si dhe vlerësuan ruajtjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare.

9.5 PROGRAMI TE NJOHIM KOMUNITETET TONA NE DIASPORE

Agjencia Kombëtare e Diasporës, përmes programit "Të njohim komunitetet tona në diasporë" synon krijimin e kontakteve me komunitetet shqiptare në diasporë, si dhe zhvillimin e bashkëpunimit me to.

Mandrica, Bullgari, korrik

Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Diasporës zhvilloi një vizitë në komunitetin shqiptar në Bullgari ku është takuar me Kryetaren e Bashkisë së qytetit Ivaylovgrad, Diana Ovcarova si dhe pjesëtarë të komunitetit shqiptar në Bullgari. Gjatë kësaj vizite u zhvillua një takim të organizuar nga ambasadorja e Shqipërisë znj. Donika Hoxha dhe Ambasadori i Kosovës z. Edon Cana ku u bisedua për marrëdhëniet mes tre shteteve si dhe projektet e përbashkëta që mund të realizohen lidhur me promovimin e turizmit dhe të vlerave kulturore të shqiptarëve në fshatin Mandricë, ku jeton komuniteti shqiptar prej vitit 1636. Pjesë e kësaj vizite ishte edhe takimi me banorët e Mandricës, ku zonjat shqiptare të fshatit të veshura me kostume popullore kënduan këngë shqiptare.



Sofje – Mandrica – Arbanasi, Bullgari, 28 – 29 nëntor

Përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilluan një vizitë në komunitetin shqiptar në Bullgari. Kjo vizitë u realizua në kuadër të zbatimit të programeve të Agjencisë Kombëtare të Diasporë për njohjen nga afër të rrënjëve dhe identitetit shqiptar në Diasporë. Gjithashtu, në këtë vizitë mori pjesë edhe një grup nxënësish ekselentë të gjimnazit "Petro Nini Luarasi" në Tiranë. Në vijim të vizitës nxënësit zhvilluan takime në ditë të ndryshme me bashkëmoshatarët e tyre në Sofje dhe Ivaylovgrad, të mundësuar nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Sofje. Në secilin takim ato prezantuan dhe shkëmbyen elemente të kulturës shqiptare, gjuhës dhe valleve tradicionale.

Grupi i nxënësve vizitoi banorët të Mandricës të cilët janë vendosur në këtë territor në vitin 1636. Banorët e Mandricës së vjetër flasin ende gjuhën shqipe, kanë kostumet popullore shqiptare dhe po përpiqen të rivitalizojnë traditat shqiptare. Banorët e Mandricës së vjetër u shprehën shumë të kënaqur nga vizitorët nga Shqipëria duke u premtuar se nuk do ta harrojnë kurrë vendin e tyre të origjinës. Nxënësit bënë dhurata me simbole kombëtare shqiptare.

Më datën 30 Nëntor 2019, u zhvillua një vizitë në fshatin Arbanas, në Bullgari. Nxënësit u njohën me historinë dhe traditat e këtij fshati i cili ishte themeluar në shekullin XV nga shqiptarë të ardhur kryesisht nga Shqipëria Jugore, Kosturi dhe Epiri, të cilët ndër vite e kthyen fshatin Arbanas në vendbanimin e tyre. Banorët tregojnë me krenari themelimin e këtij vendi nga shqiptarët, i cili është një nga pikat turistike më të preferuara të Bullgarisë dhe shënon rreth 400 mijë vizitorë në vit.

9.6 PROJEKTI DITET E SHQIPERISE

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në kuadër të promovimit të kulturës dhe traditës kombëtare në diasporë dhe prezantimit të saj në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare organizoi disa aktivitete në nismën "Ditët e Shqipërisë".

New York, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 1 dhjetor

Me rastin e festave kombëtare Agjencia Kombëtare e Diasporës, organizoi për nder të diasporës sonë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës një koncert në bashkëpunim me Teatrin e Operas, Baletit dhe Ansamblit Kombëtar dhe nën kujdesin e veçantë të Ministrit të Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, në datë 1 dhjetor 2019 në New York, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky aktivitet filloi me një minutë heshtje nga artistët dhe pjesëmarrësit në nderim të situatës së vështirë që po kalonte Shqipëria pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019. Gjithashtu, artistët dhe stafi i Agjencisë Kombëtare të Diasporës i bënë thirrje Diasporës shqiptare në SHBA për ti ardhur në ndihmë familjeve të prekura nga tërmeti.

Rotterdam, Hollandë, 3 – 5 dhjetor

Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Hagë organizoi aktivitetin "Xhubleta" me rastin e festave të nëntorit. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko, i cili në fjalën e tij, u



shpreh për situatën që po kalonte vendi ynë në atë periudhë për shkak të tërmetit të datës 26 nëntor, duke falënderuar për mbështetjen miqtë ndërkombëtarë dhe qeveritë e vendeve mike, në veçanti duke u ndalur në marrëdhënien miqësore mes dy vendeve. Në këtë aktivitet morën pjesë edhe znj. Elisa Spiropali, Ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, e cila mbajti një fjalë përshëndetëse për të pranishmit, si dhe z. Ardian Lekaj, Kryetari i Dhomës së Biznesit të Diasporës dhe anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës.

9.7 ORGANIZIME TE TJERA

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në përputhje me misionin e saj për ofrimin e ndihmës për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe identitetit kombëtar ka marrë pjesë në disa aktivitete me ftesë nga komuniteti shqiptar në diasporë.

Lubjanë, Slloveni, 6 – 7 qershor

Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko morën pjesë në aktivitetin e organizuar me rastin e 30 vjetorit të shoqatës kulturore shqiptare “Migjeni” në Lubjanë të Sllovenisë. “Migjeni” është shoqata e parë shqiptare në ish Jugosllavi, e cila ka ngulmuar në kërkesat e saj për njohjen e të drejtave të shqiptarëve. Në këtë përvjetor të rëndësishëm Ministri i Shtetit për Diasporën i dorëzoi shoqatës titullin “Naim Frashëri”, për “Veprimtarinë dhe angazhimin në mbrojtjen e çështjes kombëtare shqiptare”, titull ky akorduar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, gjatë ceremonisë iu akordua titulli Naim Frashëri (pas vdekjes) edhe ish kryetarit të kësaj shoqate, z. Gjon Simoni, ndërsa shoqata “Migjeni” në këtë përvjetor të saj, në shenjë falënderimi për punën e bërë për komunitetet shqiptare në botë i akordoi pas vdekjes z. Gjon Simoni një vlerësim mirënjohjeje. Pjesë e aktiviteteve me rastin e këtij përvjetori të shoqatës ishte edhe simpoziumi shkencor “Si e kapërcyem pragun e shpresës”, ku u pasqyruar puna tridhjetë vjeçare e shoqatës “Migjeni”.

Osnabrück, Gjermani, 14 – 16 qershor

Përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilluan një takim pune me z. Burkhard Jasper, anëtar i parlamentit të shtetit në Landin e Saksonisë së Ulët, si dhe përfaqësues të tjerë të lartë të shtetit gjerman. Gjatë këtij takimi përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Diasporës prezantuan Politikën Shtetërore për Diasporën, punën e institucionit me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e bashkëpunimit me të gjithë shqiptarët nëpër botë. Gjithashtu, përfaqësuesit e Agjencisë morën pjesë edhe në aktivitetet kulturore kushtuar mësimin dhe ruajtjes së gjuhës shqipe të organizuara në Bashkinë e Osnabrück-ut.

9.8 PLANI I PUNES PER VITIN 2020

Drejtorja e Diasporës ka planifikuar realizimin e disa programeve të reja, por edhe zgjerimin e programeve të mëparshme të cilat ndihmojnë në ruajtjen dhe promovimin e gjuhës, kulturës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare në komunitete shqiptare në diasporë. Të gjitha programet e punës dhe aktivitetet e parashikuara do të kalojnë në shqyrtim të organeve





drejtuese të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe miratohen me vendim nga Këshilli Drejtues i saj.

Aktivitetet kryesore të parashikuara për vitin 2020 janë:

- **Organizimi i Shkollës Verore 2020**

Projekti i Shkollës Verore 2020 është në proces përgatitor. Ai do të realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrinë e Kulturës. Shkolla verore 2020 do të realizohet në bazë të Programit për fëmijët e diasporës “Jam shqiptar”. Për këtë Program është caktuar me Urdhrin Nr.112/2019 të Kryeministrit, Koordinatorja Shtetërore znj. Lorena Haxhiu, zëvendësministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Programi “Jam shqiptar” ka për qëllim nxitjen e organizimit të veprimtarive kulturore dhe gjuhësore për formimin kulturor të fëmijëve pjesëmarrës nga diaspora. Ai synon ruajtjen e identitetit kombëtar, kulturor dhe gjuhësor shqiptar në kushtet e distancës nga vendi i origjinës.

Me anë të këtij programi synohet që së paku një herë në jetë të rinjtë shqiptarë të moshave 11-18 vjeç që jetojnë në diasporë të vijnë për periudha jo më pak se 7 ditë në Shqipëri dhe të rizbulojnë dhe prekin nga afër rrënjët e origjinës së tyre.

Në kuadër të këtij programi, Agjencia Kombëtare e Diasporës do të administrojë tarifat për çdo paketë turistike të paguar nga pjesëmarrësit në kurset e Programit “Jam shqiptar” të cilat miratohen nga Koordinatorja Shtetërore e Programit. Paketat turistike përgatiten nga Agjencia Kombëtare e Turizmit dhe publikohen nga Koordinatorja Shtetërore në faqet zyrtare të institucioneve të arsimit parauniversitar dhe faqen e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, duke ju dhënë mundësinë e zgjedhjes së paketës secilit pjesëmarrës. Të gjitha të ardhurat e grumbulluara do të përdoren për mbulimin e kostove të aktiviteteve të kurseve të gjuhës dhe shkollës shqipe si dhe do të publikohen në një raport transparence brenda një muaji nga ardhja e grupit të fundit. Agjencia Kombëtare e Diasporës mbulon koston e dietave për mësuesit dhe personelin mbështetës të Agjencisë të cilët mbikëqyrin aktivitetet e kurseve të gjuhës dhe kulturës shqipe gjatë gjithë kohëzgjatjes dhe i publikon ato në raportin e transparencës dhe pranë Koordinatorit Shtetëror të Programit “Jam shqiptar”.

- **Koordinimi i zyrave për diasporën në nivel vendor**

Në bazë të ligjit Nr.38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në çdo bashki do të krijohet një strukturë e posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor. Agjencia Kombëtare e Diasporës do të luajë rolin kryesor në koordinimin e punës së zyrave të reja dhe në ofrimin e eksperiencës për punonjësit e rinj të këtyre zyrave. Për këtë qëllim, në bashkëpunim me

Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit (IOM) dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike do të organizohen trajnime të vazhdueshme të stafit të këtyre zyrave.

- **Zgjerimi i programit të mësimit të gjuhës shqipe**

Gjatë vitit 2019 Agjencia Kombëtare e Diasporës filloi zbatimin e programit të mësimit të gjuhës shqipe për komunitetet shqiptare në diasporë. Ky program filloi me Ukrainën dhe





Kroacinë, ndërsa për vitin 2020 duke nisur nga suksesi që pati programi i parë synohet zgjerimi i programit të mësimit të gjuhës shqipe vende të tjera pritëse të komuniteteve shqiptare si Italia (komunitetet arbëreshe), Greqia etj.

- **Vazhdimi i Projektit “Ditët e Shqipërisë”**

Ditët e Shqipërisë do të organizohen në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme në shtete të ndryshme të botës me qëllim promovimin e traditave dhe kulturës shqiptare. Gjatë aktiviteteve do të jenë prezent shoqata dhe përfaqësues nga komuniteti shqiptar dhe nga komuniteti i vendeve pritëse. Planifikohet që Ditët e Shqipërisë të organizohen edhe me pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës.

- **Dita e Remitancave**

Dita Ndërkombëtare e Remitancave të Familjes (16 qershori), është një ditë e rëndësishme për të vlerësuar përpjekjet e vazhdueshme të qindra-mijëra migrantëve shqiptarë, të cilët me të ardhurat e tyre, sigurojnë një të ardhme më të mirë për fëmijët dhe ndihmojnë familjet në Shqipëri. Duke vlerësuar këtë kontribut, përmes organizimit të një aktiviteti, pjesëmarrësit do të informohen për përfitimet e mirëmenaxhimit të remitancave në dobi të familjeve e të vendit.

- **Ditët e Kulinarisë**

Organizimi i “Ditëve të kulinarisë” nëpërmjet panairove të ushqimit synon ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare dhe nxitjen e shkëmbimit të kulturave gastronomike në vendet pritëse të diasporës, promovimin dhe shërbimin e specialiteteve të kulinarisë shqiptare, si pjesë e kulturës dhe identitetit tonë.

- **Takimi i Mjekësisë në Diasporë**

Me qëllim organizimin e Takimit të Mjekësisë në Diasporë, në datë 20 shkurt 2020, janë zhvilluar disa takime me stafin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në kuadër të përgatitjeve për takimin, janë dërguar ftesat elektronike për pjesëmarrje tek anëtarët e Diasporës shqiptare. Ndërkohë, është në proces hartimi i programit për takimin. Ky takim synon të krijojë rrjetëzimin e mjekëve, infermierëve shqiptarë kudo në botë dhe kërkon të kthehet në një takim të përvitshëm ku profesionistët në fushën e mjekësisë të mbledhen dhe shpalosin idetë e tyre, propozimet për përmirësimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në vend si dhe rishikimin e kthimit në Shqipëri përmes politikave shtetërore.

- **Takimi i Juristëve në Diasporë**

Agjencia Kombëtare e Diasporës me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën do të organizojë takimin e juristëve në diasporë. Ky takim do të zhvillohet në datën 4 prill 2020. Ky takim synon të mbledhë juristë, avokatë, profesionistë të së drejtës që operojnë jashtë vendit me qëllim angazhimin e tyre edhe në hartimin e paketave ligjore vendase si dhe “përthithjen” e elementëve më cilësorë të cilët mund të kontribuojnë në kuadër të reformës në drejtësi.



X. RAPORTIMI I DREJTORISE SE FINANCES DHE SHERBIMEVE MBESHTESE


10.1 ANALIZË FINANCIARE 2019

Agjencia Kombëtare e Diasporës, për realizimin e buxhetit të shtetit të vitit 2019 është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale dhe zbatimin korrekt të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 115, datë 18.12.2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018-2024 dhe Planit të Veprimit.

Ky raport përfshin periudhën Janar – Dhjetor 2019, që është viti i parë i funksionimit të plotë të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Në zbatim të Ligjit Nr.99/2018, “Për Buxhetin e vitit 2019”, Agjencisë Kombëtare të Diasporës i është akorduar një fond buxhetor prej 81.500.000 lekë, i cili përbëhet nga:

- | | |
|--|-----------------|
| • Shpenzime personeli (paga dhe sigurime) | 16.500.000 lekë |
| • Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime) | 65.000.000 lekë |




Në zbatim të Ligjit Nr.99/2018, “Për Buxhetin e vitit 2019”, Agjencia Kombëtare e Diasporës realizoi vlerën buxhetore prej 73,427,700 lekë.

Agjencia Kombëtare e Diasporës, referuar buxhetit të vitit 2019, ka zbatuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme, në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Në përfundim të vitit 2019 rezulton se shpenzimet faktike të realizuara për këtë vit, janë si më poshtë:



• Fondi i Pagave	11,158,173	lekë
• Fondi i Sigurimeve Shoqërore	1,854,189	lekë
• Fondi për Shpenzime Korrente	60,415,338	lekë



1. Shpenzime për Fondin e pagave dhe sigurimeve (600,601)

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë këtij viti, numri mesatar i punonjësve u realizua deri në 13 punonjës, nga 15 punonjës të miratuar me Urdhrin nr. 53, datë 16.03.2018 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 11,158,173 lekë, ose 77 % e fondit të planifikuar për vitin 2019 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 1,854,189 lekë, ose 93 %, e planifikimit për periudhën respektive.

2. Shpenzimet Korrente(mallra dhe shërbime,602)

Fondi i shpenzime korrente është realizuar në vlerën 60,415,338 lekë ose 93 % e fondit të planifikuar për vitin 2019.

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë vitit 2019, në realizimin e shpenzimeve korrente, është mbështetur në kërkesa të cilat lidhen me:

- Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime.



- Realizimin e shpenzimeve për blerje materialesh e shërbimesh, sipas nevojave konkrete, për krijimin dhe përmirësimin e kushteve të punës në realizimin e një aktiviteti normal institucional. të tilla si shpenzime për udhëtime jashtë vendit,dieta,akomodim, materiale promocionale, kancelari, shërbim printimi, honorare,etj.

Gjatë këtij viti u realizuan me sukses takime dhe aktivitete të larmishme në vende të ndryshme ku gjenden komunitete shqiptare në Diasporë. Në tabelën e mëposhtme paraqiten takimet dhe aktivitete me elementet përbërës të tyre.

TABELA E DETAJIMIT TË SHPENZIMEVE KORRENTE

Nr.	AKTIVITETET	SHPENZIMET
1	Aktivite për Komunitetin Shqiptar të Ukrainës	11,854,723.00
1.1	Mësimi i valleve dhe këngëve popullore në Karakurt	1,755,530
1.2	Mësimi i valleve dhe këngëve popullore në Zaporozhje	819,950
1.3	Mësimi i gjuhës shqipe në Karakurt (Mësuesit në Karakurt)	407,819
1.4	Koncert përmbyllës në Odessa(TOB)	7,813,820
1.5	Takime Praprake	1,057,604
2	Aktivite për Komunitetin Shqiptar të Italisë	9,724,658
2.1	Java kulturore (Simpozium në Puglia)	1,844,024
2.2	Koncert në Itali (Dy koncerte:koncert klasik në Piana dei albanesi dhe koncert i TOB)	7,537,508
2.3	Takime Paraprake	343,126
3	Aktivite për Komunitetin Shqiptar të Kroacisë	5,113,855
3.1	Mësimi i valleve ,këngëve popullore si dhe organizim i një shfaqje teatrale në Zara	709,607
3.2	Mësimi i gjuhës shqipe në Zara(Mësuesit në Zara)	451,789
3.3	Koncert klasik, përmbyllës i aktiviteteve në Zara,Kroaci	3,345,056
3.4	Takime Paraprake	607,403
4	Të njohim komunitetet tona në Diasporë	968,459
4.1	Vizitë e nxënësve shqiptarë në komunitetin shqiptar në Bullgari në bashkëpunim me ambasadën shqiptare në Sofje dhe shoqatën “Tradita Popullore”.	968,459
5	Ditët e Shqipërisë	17,451,100
5.1	Koncert I TOB në New York(Usa)	15,993,380
5.2	Simpozium “xhubleta” në Rotterdam dhe Hagë,Hollandë	1,886,520
6	Dita e Diasporës(Mbledhja e KKD)	3,646,477
7	Shpenzime të tjera (shpenzime për samitin, s hpenzime administrative, shpenzime promocionale)	11,227,266
	TOTALI	60,415,338


TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI

Llog.Ek	Pershkrimi	Buxheti Plan 2019	Buxheti I Realizuar 2019	Buxheti I Realizuar %
600	Fond Page	14,500,000.00	11,158,173	77 %
601	Kontrib. Sig.Shoqerore & Shendetesore	2,000,000.00	1,854,189	93 %
602	Shpenzime Korrente	65,000,000.00	60,415,338	93 %

10.2 ORGANIZIMI I DREJTORISË SË FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Financa

Gjatë këtij viti sektori i financës ka evidentuar me përpikmëri nëpërmjet kontabilizimeve në ditarët përkatës (ditari magazinës si dhe shpenzimeve të arkës dhe të bankës) të gjitha shpenzimet e kryera në valutë si edhe në lekë.

Në zbatim të ligjit për menaxhimin financiar si dhe udhëzimit në zbatim të tij, sektori i financës ka përgatitur të gjitha urdhër-shpenzimet në afatin e caktuar për faturat e paraqitura nga kryerja e prokurimeve publike, pagesat për pagat, honoraret dhe dietat e punonjësve. Janë përgatitur dhe likuiduar 220 urdhër shpenzime.

Në muajin dhjetor u krye inventarizimi i aseteve të Agjencisë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Janë përgatitur brenda afatit të gjitha listëpagesat për pagat si dhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve. Në vitin 2019 pagesat e pagave të punonjësve janë kryer nëpërmjet listë pagesave dhe urdhër shpenzimeve të gjeneruara nga sistemi HRMIS.

Janë përgatitur raportimet për Ministrinë e Financave, rakordimet me Degën e Thesarit si dhe çdo informacion tjetër i kërkuar me karakter financiar.

Burime Njerëzore

Burimet njerëzore janë një faktor i rëndësishëm në realizimin e objektivave kryesorë institucionalë. Në këtë kontekst, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka patur si objektiv parësor jo vetëm ngritjen e kapaciteteve të brendshme por dhe ruajtjen e një strukture organike që do ti mundësonte eficiencë në realizimin e misionit të saj. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore në Agjenci është i orientuar drejt administrimit me korrektësi të dosjeve të personelit, si dhe



vlerësimi vjetor të performancës në punë për çdo punonjës, në kohë dhe në përputhje me rregullat administrative përkatëse. Identifikimi i nevojave të personelit për përmirësimin e aftësive profesionale të tyre nëpërmjet realizimit të trajnimeve në përshtatje me nevojat profesionale të vendit të punës me qëllim përballimin e sfidave të ndryshme në të ardhmen, janë një element të cilit Agjencia i kushton një vëmendje të veçantë.

Në bashkëpunim me ASPA-n, është realizuar me sukses, trajnimi i detyrueshëm për punonjësit e Agjencisë në periudhë prove si dhe trajnime në fushën e prokurimeve, konsultimit publik. Në vitin 2019, janë trajnuar punonjësit e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve, për implementimin dhe përdorimin e sistemit të HRMIS-së. Në vijim të trajnimit, është realizuar me korrektësi dhe brenda afateve, krijimi i dosjeve elektronike në sistemin e HRMIS-së për çdo punonjës të institucionit. Në kuadër të zhvillimit profesional të stafit, janë realizuar trajnime në fushën e hartimit e projekteve dhe zbatimit të tyre.

Për të mundur realizimin me eficiencë të objektivave dhe misionit të institucionit, në bashkëpunim me DAP-in, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore janë ndjekur procedurat për plotësimin e vendeve vakante.

Për nevojat e institucionit, është shtuar një pozicion mbi strukturë sipas vendimit nr. 483, datë 10.07.2019 i Këshillit të Ministrave, "Për Përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2019 në njësitë e qeverisjes qendrore".

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në përputhje me Ligjin, "Për nëpunësin civil", ka realizuar përgatitjen e dosjeve të personelit, si dhe raportime periodike në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Gjatë këtij viti në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ligji "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe nëpunësve publik", autoriteti përgjegjës ka ndjekur depozitimin në kohë të formularit të Deklarimit të Interesave Privatë Periodik/Vjetor.

Protokolli

Në bazë të ligjit "Për Arkivat", është bërë pritja e shkresave të hyra në institucionin, duke i vendosur kartelën shoqëruese, numrat e protokollit dhe përcjelljen e tyre drejt Drejtuesit të Institucionit, i cili bën shpërndarjen e shkresave sipas drejtorive përkatëse.

Është kryer procedura ligjore për shkresat dalëse të institucionit tonë, duke verifikuar fillimisht plotësimin e kushteve dhe parametrave që përcakton ligji ynë në pjesën e ndërtimit të shkresave, vendosjen e numrit të protokollit, dërgimit të tyre drejt Drejtuesit të Institucionit për firmosje dhe vulosje dhe së fundmi klasifikimin e dokumenteve sipas strukturave organizative të institucionit.



Magazina

Në hyrjen dhe shpërndarjen e artikujve nga magazina është ndjekur procedura ligjore duke bërë evidentimet e nevojshme në fletë-hyrjet, fletë-daljet dhe janë bërë pasqyrimet në Librin e Magazinës për sasitë artikujve të dala nga magazina dhe gjendjen e tyre të mbetur në magazinë. Në fund të vitit u krye inventarizimi i aktiveve.

Prokurime

Në zbatim të planit për shpenzime, AKD ka hartuar e zbatuar edhe regjistrin e prokurimeve, i cili gjatë vitit 2019 është realizuar nëpërmjet procedurave të prokurimit me vlera të vogla si dhe 1(një) procedurë “Kërkesë për propozim”. Bazuar në ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, të ndryshuar, VKM nr.914 datë. 29.12.2014 ,të ndryshuar, si dhe udhëzimeve përkatëse, në periudhën Janar-Dhjetor janë kryer dhe realizuar me sukses procedurat e prokurimit publik me objekt të ndryshëm prokurimi duke përfshirë “artikuj promocionale”, “kancelari”, “printim dhe botim”, “Blerje libra në gjuhën shqipe”, “Blerje biletash ndërkombëtare në sistemin dinamik” etj. Janë krijuar në sistemin elektronik të APP-së gjithsej 72 procedura prokurimi, nga të cilat 14 janë anuluar dhe janë rihedhur pasi asnjë nga operatorët ekonomikë nuk përmbushte kërkesat e Autoritetit Kontraktor, ndërsa 58 procedura prokurimi u realizuan me sukses.

XI. MARREVESHJE BASHKËPUNIMI TE NENSHKRUARA

- MARRËVESHJE NDËRMJET AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS DHE FAKULTETIT TË HISTORISË DHE TË FILOLOGJISË UNIVERSITETI I TIRANËS “PËR BASHKËPUNIMIN NË RUAJTJEN E GJUHËS DHE IDENTITETIT KOMBËTAR NË DIASPORË”
- MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MIDIS AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS DHE TEATRIT KOMBËTAR TË OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRIS“ ËPËR BASHKËPUNIMIN NË RUAJTJEN DHE PROMOVIMIN E IDENTITETIT KULTUROR KOMBËTAR NË DIASPORË”
- MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRMJET AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS DHE FONDACIONIT “TRADITA POPULLORE”
- MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MIDIS AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS DHE TEATRIT “MIGJENI”, SHKODËR “PËR BASHKËPUNIMIN NË RUAJTJEN DHE PROMOVIMIN E IDENTITETIT KULTUROR KOMBËTAR NË DIASPORE



XII. PUBLIKIME TE AGJENCISE KOMBETARE TE DIASPORES

- BULETINI INFORMUES (MARS, QERSHOR, SHTATOR, DHJETOR, BULETINI VJETOR 2019)
- PROGRAMI SHTETËROR I AKTIVITETEVE PËR DIASPORËN SHQIPTARE 2019
- REVISTA ELEKTRONIKE E KESHILLIT KOORDINUES TE DIASPORES
- REVISTA ELEKTRONIKE E KOMITETIT SHTETEROR TE DIASPORES
- REVISTA “VENDIMMARRJA DHE TRANSPARENCA” PER SAMITIN E DYTE TE DIASPORES
- REVISTA INFORMATIVE E AGJENCISE KOMBETARE TE DIASPORES
- POLITIKA SHTETERORE PER DIASPOREN 2019


SHTOJCA 1: AKTE TE KESHILLIT DREJTUES SIPAS MBLEDHJEVE
VENDIM
Nr. 1, datë 04.02.2019
PËR
“MIRATIMIN E PLANIT PËR DETAJIMIN BUXHETOR PËR VITIN 2019”

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr. 115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të Vendimit Nr. 114/2018 të Këshillit të Ministrave “Për emerimin, shkarkimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të Urdhrit Nr. 1, datë 25.09.2018, të Ministrit të Shtetit për Diasporën “Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

1. Miratimin e planit për detajimin buxhetor për vitin 2019, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Me zbatimin e vendimit ngarkohet Agjencia Kombëtare e Diasporës.

Ky vendim hyri në fuqi menjëherë,

KËSHILLI DREJTUES

Etjen	XHAFAJ	KRYETAR
Rovena	VODA	ANËTARE
Anila	FERIZAJ	ANËTARE
Ornela	ÇUÇI	ANËTARE
Elona	BANO	ANËTARE
Suzana	STEFA	ANËTARE
Mimoza	HYSA	ANËTARE


VENDIM
Nr. 2, datë 18.03.2019
PËR
**“MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR 2018, AKTIVITETEVE TË ZHVILLUARA
DHE PASQYRËS FINANCIARE”**

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr. 115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të Vendimit Nr. 114/2018 të Këshillit të Ministrave “Për emerimin, shkarkimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të Urdhrit Nr. 1, datë 25.09.2018, të Ministrit të Shtetit për Diasporën “Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, i ndryshuar Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit vjetor 2018, Aktiviteteve të Zhvilluara dhe Pasqyrës Financiare, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Me zbatimin e vendimit ngarkohet Agjencia Kombëtare e Diasporës.

Ky vendim hyri në fuqi menjëherë,

KËSHILLI DREJTUES

Etjen	XHAFAJ	KRYETAR
Rovena	VODA	ANËTARE
Anila	FERIZAJ	ANËTARE
Ornela	ÇUÇI	ANËTARE
Elona	BANO	ANËTARE
Suzana	STEFJA	ANËTARE
Mimoza	HYSA	ANËTARE





VENDIM QARKULLUES

Nr. 3, datë 26.08.2019

**“PËR MIRATIMIN E PROGRAMEVE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË
DIASPORËS PËR PERIUdhËN GUSHT- DHJETOR 2019”**

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr. 115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të vendimit Nr. 114/2018 të Këshillit të Ministrave “Për emerimin, shkarkimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

1. Miratimin e programeve të detajuar të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për periudhën Gusht-Dhjetor 2019, me vlerë totale 57,841,331 (pesëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e dyzet e një mijë e treqind e tridhjetë e një), bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyri në fuqi menjëherë,

KËSHILLI DREJTUES

Etjen	XHAFAJ	KRYETAR
Rovena	VODA	ANËTARE
Anila	FERIZAJ	ANËTARE
Ornela	ÇUÇI	ANËTARE
Elona	BANO	ANËTARE
Suzana	STEFA	ANËTARE
Kozeta	ANGJELIU	ANËTARE


**PARASHIKIMI I PROGRAMEVE TË AKD-SË PËR PERIUdhËN
GUSHT- DHJETOR 2019**

Nr.	PROGRAMI	KOSTO	AFATE REALIZIMI
1	Aktivite për Komunitetin Shqiptar të Ukrainës	7,746,430	
1.1	Mësimi i valleve dhe këngëve popullore në Zaporozhje	756,620	1-15 tetor
1.2	Mësimi i gjuhës shqipe në Karakurt	735,150	1-15 shtator
1.3	Mësimi i gjuhës shqipe në Zaporozhje	735,150	1-15 tetor
1.4	Koncert përmbyllës në Odessa	5,519,510	1-15 tetor
2	Aktivite për Komunitetin Shqiptar të Italisë	14,941,040	
2.1	Java kulturore (Puglia)	3,260,540	1-7 nëntor
2.2	Vizitë e nxënësve nga komuniteti arbëresh në Shqipëri	7,180,500	shtator
2.3	Koncert në Itali	4,500,000	5 shtator
3	Aktivite për Komunitetin Shqiptar të Kroacisë	6,595,858	
3.1	Mësimi i valleve dhe këngëve popullore në Zara	756,620	1-15 dhjetor
3.2	Mësimi i gjuhës shqipe në Zara	719,700	1-15 dhjetor
3.3	Koncert përmbyllës	5,119,538	dhjetor
4	Të njohim komunitetet tona në Diasporë	1,380,250	
4.1	Vizitë e nxënësve shqiptar në komunitetin shqiptar në Bullgari	1,380,250	
5	Ditët e Shqipërisë	3,445,000	bashkëpunim me MEPJ
6	Dita e Diasporës	5,615,400	18 dhjetor
7	Ditët e Kulinarisë	1,962,000	bashkëpunim me MEPJ
8	Samiti i grave	7,900,000	16-17 janar
9	Shpenzime të tjera	8,255,353	
	TOTALI	57,841,331	


VENDIM QARKULLUES
Nr. 4, datë 05.11.2019
**“PËR MIRATIMIN E PROGRAMEVE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË
DIASPORËS PËR PERIUdhËN NËNTOR-DHJETOR 2019”**

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr. 115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të vendimit Nr. 114/2018 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

1. Miratimin e programeve të rishikuara të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për periudhën Nëntor-Dhjetor 2019, me vlerë 31,548,507 (tridhjetë e një milion e pesëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind e shtatë) lekë, bashkëlidhur këtij vendimi. Rialokimi është për vlera brenda buxhetit vjetor, kursyer nga aktivitetet e parashikuara më parë brenda planit të aktiviteteve vjetore të Agjencisë, duke mundësuar zhvillimin e aktiviteteve shtesë, brenda buxhetit të Agjencisë, sipas prioriteteve. Kjo vlerë është pjesë e mbetur e shumës prej 57,841,331 (pesëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e dyzet e një mijë e treqind e tridhjetë e një) lekë, pas realizimit të aktiviteteve të miratuara me Vendimin Nr. 3, datë 26.08.2019 të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Ky vendim hyri në fuqi menjëherë,

KËSHILLI DREJTUES

Etjen	XHAFAJ	KRYETAR
Rovena	VODA	ANËTARE
Anila	FERIZAJ	ANËTARE
Ornela	ÇUÇI	ANËTARE
Elona	BANO	ANËTARE
Suzana	STEFA	ANËTARE
Kozeta	ANGJELIU	ANËTARE


**PARASHIKIMI I PROGRAMEVE TË AKD-SË PËR PERIUDHËN
TETOR- DHJETOR 2019**

Nr.	PROGRAMI	KOSTO	AFATE REALIZIMI
1	Aktivite për Komunitetin Shqiptar të Ukrainës	8,919,890	Realizuar
1.1	Mësimi i valleve dhe këngëve popullore në Zaparozhje	819,950	Realizuar
1.2	Mësimi i gjuhës shqipe në Karakurt (Mësuesit në Karakurt)	407,400	Realizuar
1.3	Koncert përmbyllës në Odessa (TOB)	6,863,420	Realizuar
1.4	Mësimi i gjuhës shqipe në Zaparozhje	481,200	Në proces realizimi
1.5	Takime të mëparshme dhe vizita paraprake për aktivitetet	347,920	Realizuar
2	Aktivite për Komunitetin Shqiptar të Italisë	9,381,532	Realizuar
2.1	Java kulturore (Simposium në Puglia)	1,844,024	Realizuar
2.2	Koncert në Itali (Dy koncerte: Koncerti klasik në Piana degli Albanesi dhe koncert i TOB)	7,537,508	Realizuar
3	Aktivite për Komunitetin Shqiptar të Kroacisë	6,604,963	Në proces realizimi
3.1	Mësimi i valleve, këngëve popullore si dhe organizim i një shfaqje teatrale nga një Teatër profesionist, në Zara	724,487	13-15 nëntor
3.2	Mësimi i gjuhës shqipe në Zara (Mësuesit në Zara)	719,700	Realizuar
3.3	Koncert klasik, përmbyllës i aktiviteve në Zara, Kroaci	5,000,000	27 dhjetor
3.4	Takime të mëparshme dhe vizita paraprake për aktivitetet	399,276	Realizuar
4	Të njohim komunitetet tona në Diasporë	1,386,439	
4.1	Vizitë e nxënësve shqiptarë me rastin e festave të Nëntorit në komunitetin shqiptar në Bullgari në bashkëpunim me Ambasadën shqiptare në Sofje si dhe shoqatën "Tradita Popullore"	1,386,439	27 Nëntor- 1 Dhjetor
5	Ditët e Shqipërisë	22,786,640	
5.1	Koncert i TOB në New York (USA) me rastin e festave të Nëntorit	15,2420,400	1 dhjetor




**AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS**

5.2	Simpozium “Xhubleta – enigma 4 mijë vjeçare si mesazh nga Alpet e Mesdheut” në Rotterdam dhe Hagë, Holandë	2,256,900	3-5 dhjetor
5.3	Koncert në Selanik, Greqi (këngëtarë dhe artistë me famë botërore)	5,287,340	13 dhjetor
6	Dita e Diasporës në Tiranë (mbledhja e KKD)	5,615,400	18 dhjetor
7	Shpenzime të tjera	3,146,467	
	TOTALI	57,841,331	
	PROGRAME PËR TU MIRATUAR	31,548,507	Nëntor - Dhjetor



**VENDIM****Nr. 5, datë 30.12.2019****PËR****“MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË AGJENCISË KOMBËTARE TË
DIASPORËS PËR VITIN 2019”**

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr. 115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të vendimit Nr. 114/2018 të Këshillit të Ministrave “Për emerimin, shkarkimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

3. Miratimin e Raportit vjetor të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për vitin 2019”.
4. Me zbatimin e vendimit ngarkohet Agjencia Kombëtare e Diasporës.

Ky vendim hyri në fuqi menjëherë,

KËSHILLI DREJTUES

Etjen	XHAFAJ	KRYETAR
Rovena	VODA	ANËTARE
Anila	FERIZAJ	ANËTARE
Ornela	ÇUÇI	ANËTARE
Elona	BANO	ANËTARE
Suzana	STEFJA	ANËTARE
Kozeta	ANGJELIU	ANËTARE



**VENDIM****Nr.6, datë 30.12.2019****PËR****“MIRATIMIN E BULETINIT NR. 4, DHJETOR 2019”**

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr. 115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të vendimit Nr. 114/2018 të Këshillit të Ministrave “Për emerimin, shkarkimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

1. Miratimin e Buletinit Nr. 4, dhjetor 2019.
2. Me zbatimin e vendimit ngarkohet Agjencia Kombëtare e Diasporës.

Ky vendim hyri në fuqi menjëherë,

KËSHILLI DREJTUES

Etjen	XHAFAJ	KRYETAR
Rovena	VODA	ANËTARE
Anila	FERIZAJ	ANËTARE
Ornela	ÇUÇI	ANËTARE
Elona	BANO	ANËTARE
Suzana	STEFJA	ANËTARE
Kozeta	ANGJELIU	ANËTARE




VENDIM
Nr.7, datë 30.12.2019

**PËR
“MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË
INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE NË AGJENCINË
KOMBËTARE TË DIASPORËS”**

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr. 115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të vendimit Nr. 114/2018 të Këshillit të Ministrave “Për emerimin, shkarkimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

3. Miratimin e Rregullores për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Agjencinë Kombëtare të Diasporës.
4. Me zbatimin e vendimit ngarkohet Agjencia Kombëtare e Diasporës.

Ky vendim hyri në fuqi menjëherë,

KËSHILLI DREJTUES

Etjen	XHAFAJ	KRYETAR
Rovena	VODA	ANËTARE
Anila	FERIZAJ	ANËTARE
Ornela	ÇUÇI	ANËTARE
Elona	BANO	ANËTARE
Suzana	STEFJA	ANËTARE
Kozeta	ANGJELIU	ANËTARE



SHTOJCA 2: TREGUES I LEGJISLACIONIT NE VITIN 2019

KOMITETI SHTETËROR PËR DIASPORËN

- Urdhër Nr. 45, datë 12.02.2019 i Kryeministrit “Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Informimin e Diasporës”
- Urdhër Nr. 43, datë 12.02.2019 i Kryeministrit “Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Marrëveshjet Shtetërore në Fushën e Sigurimeve për Shtetasit Shqiptarë Jashtë Vendit”
- Urdhër Nr.44, datë 12.02.2019 i Kryeministrit “Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Organizimin e Programit Vjetor të Aktiviteteve për Diasporën Shqiptare”
- Urdhër Nr.47, datë 18.02.2019 i Kryeministrit “Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Programet/Donatorët të Cilët Ofrojnë Bursa Studimi për Jashtë Vendit”
- Urdhër Nr.78, datë 17.04.2019 i Kryeministrit “Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Marrëveshjet Shtetërore në Fushën e Njohjes së Lejeve të Drejtimit të Automjeteve për Shtetasit Shqiptarë Jashtë Vendit”
- Urdhër Nr. 92, datë 17.05.2019 i Kryeministrit “Për Ngritjen e Grupit të Punës dhe Caktimin e Personit Përgjegjës për Mbrojtjen e të Drejtave të Shqiptarëve që Vuajnë Heqjen e Lirisë Jashtë Vendit, të Drejtave të Migrantëve Nëpërmjet Informimit mbi Mundësitë e Ndryshme për të Apeluar Ndaj Shkeljeve të të Drejtave të Tyre, në Strukturat e Vendeve Pritëse si dhe në ato Ndërkombëtare”
- Urdhër Nr.112, datë 30.08.2019 i Kryeministrit “Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Realizimin e Programit “Jam shqiptar” të Gjuhës dhe Kulturës Shqipe”

MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

- Urdhër Nr.124, datë 18.09.2019 i Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”
- Vendimi Nr. 11, datë 09.01.2019 i Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2019 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”
- Urdhër Nr. 50, datë 27.02.2019 i Kryeministrit “Për dhënien e çmimit “Ambasador i Kombit”
- Vendimi Nr. 104, datë 28.02.2019 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë”.
- Vendimi Nr. 195, datë 05.04.2019 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës”.
- Vendimi Nr. 320, datë 15.05.2019 i Këshillit të Ministrave “Për statusin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës”.



AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

- Vendimi Nr. 443, datë 26.06.2019 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”.
- Vendimi Nr.601. datë 4.9.2019 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”.
- Vendimi Nr.780, datë 6.11.2019, “Për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi”,
- Ligji Nr. 38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

MARRËVESHJE DHE MEMORANDUME

- Memorandum bashkëpunimi për programin “Jam shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Kulturës dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën.
- Marrëveshje ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë Universiteti i Tiranës për bashkëpunimin në ruajtjen e gjuhës dhe identitetit kombëtar në Diasporë.
- Marrëveshje bashkëpunimi midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor kombëtar në Diasporë.

